

INFORMACION PËR NDËRVEPRIMIN NË MJEDIS

EMËRTIMI I PROJEKTIT:
SHFRYTËZIM I MINERALIT GUR GËLQEROR

VENDODHJA:
QARKU TIRANË, BASHKIA TIRANË, NJËSIA ADMINISTRATIVE
KRRABË, SKUTERË, OBJEKTI "SKUTERRE", ZONA MINERARE
NR.318/1 (ISH LEJA MINERARE NR. 1206)

(Sipas shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", i ndryshuar, Shtojca I, pika 19: Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë. Procedurë e thelluar e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.)

Kërkues:
Subjekti "ANCHOR INVESTMENTS" Sh.p.k
NIPT: L714210161

Informacion Për Ndërveprimin Në Mjedis u hartua nga:

Adhurim Çausi

Ekspert Mjedis

ADHURIM ÇAUSHI



Shtator, 2021



TABELA:
PËRMBAJTJA E LËNDËS

HYRJE

1. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.....	2
2. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.....	22
3. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.....	31
4. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.....	46
5. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.....	47
6. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS.....	47
7. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.....	48
8. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.....	49
9. NDIKIMET NË MJEDISIN NDËRKUFITAR TË PROJEKTIT	52

1. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHEM TË ZBATOHET PROJEKTI.

Tokat

Gelqeroret qe ndertojne objektin qe eshte mare ne trajtim ne kete studim, ne pergjithesi praqiten ne forme pakosh te mbivendosura mbi njera-tjetren me alterim te gelqeroreve te dolomitizuar dhe me mbushje te materialit allokon kryesisht ne siperfaqe Gelqeroret kane shtrirje Veri Perendim Jug Lindje me azimut renie te gelqeroreve rreth 40-50°.



Gelqeroret jane te çveshur dhe dalin direkt ne siperfaqe ku duket qarte edhe prezenca e tokes vegjetale dhe kjo ka kushtezuar edhe pranine e bimesise e cila eshte shume e rralle ku lartesia e bimesise nuk i kalon 0.5-1m.

Duhet te theksojme qe fenomeni i karstit eshte i zhvilluar kjo duket qarte ne disa gropa te vogla sidomos ne pjesen Lindore te zones ku zona duket me terren te bute.


Nga pikpamja gjeografike terreni ku shtrihet objekti qe kerkohet per shfrytezim, eshte terren malor , i nderthurur ndermjet pjeses kodrinore dhe asaj malore, lartesite e te cilave jane mbi 900 m mbi nivelin e detit. Vete terreni ku kerkohet leja minerare eshte pak i aksidentuar dhe i shpelare nga erozioni ne

pjesen Perendimore kurse pjesa Veri Lindore eshte teren i qete. Ne pjesen e poshteme te tij ka depozitime te konsiderueshme copezore te shkembinjve gelqerore, qe ndertojne pjeset e siperme te tij si dhe depozitime flishore mbi te cilat eshte zhvilluara bimesia lokale ne trajte shkuresh.

Bimesia e rajonit

Pothuajse në të gjithë zonat periferike dhe qendrore të qytetit të Tiranës, vërehet një mungesë e theksuar e hapësirave të gjelbërta dhe parqeve publike. Kryesisht gjelbërimi është i përqëndruar përgjatë segmenteve rrugore, në pjesën e trotuareve, përgjatë shtratit të Lumit të Lanës dhe në disa mini lulishte, të tilla si: Lulishtja "Një Maji", pranë Bluevardit "Bajram Curri", Lulishtja pranë Presidencës, etj. Përsa i përket parqeve të gjelbërta të mirëfillta, në këtë zonë është vetëm Parku Natyror i Liqenit Artificial të Tiranës. Ky është i vetmi vend rekreacioni dhe i zhvillimit të sporteve të lehta, vrapimit, shëtitjes etj. Në këto kushte, do të ishte me vend që këto sipërfaqe të lira të mbetura pa ndërtim, pjesërisht ose të gjitha të projektohen dhe të realizohen si hapësira publike të gjelbëruara. Bimësia e zonës është ajo e pemëve dhe lulishteve të qytetit si ato të pedonale Rrugës "Murat Toptani", të Rrugës "Sulejman Delvina", të Bulevardit "Gjergj Fishta", të Bulevardit "Bajram Curri", Bulevardi "Zogu I", etj. Ato të parkut Rinia, rrepe dhe bimësi barishtore, si edhe sheshi "Skënderbej", lulishtja tek Sahati, mbrapa pallatit të Operas e rrugët dytësore, të cilat kanë bimësi barishtore dhe pemë të llojeve të ndryshme, si kumbulla, manjola, rrepe, bli, etj. Bimësia e rajonit të Tiranës është e llojit shkurre mesdhetare, tipike e zonave të mesdheut dhe klimës së rajonit. Siperfaqja në vlerësim, ndodhet prane monumentit te natyres "Gryka e Murdharit", por per te mos cenuar dhe mos prekur siperfaqen eshte propozuar se nga siperfaqja totale te shfrytezohet vetem **zona A** e paraqitur ne ortofoto si me poshte.

Pamje satelitore e sipërfaqes së shfrytëzimit dhe bimësisë së rajonit



Pamje e bimësisë përreth dhe në sipërfaqen e shfrytëzimit



Biodiversiteti

(Referuar Raportit të gjendjes së mjedisit për vitin 2019, Agjencia Kombëtare e Mjedisit).

Shqipëria është e njohur për shumëllojshmërinë e saj të lartë të burimeve gjenetike, specieve dhe ekosistemeve. Njihet gjithashtu si një vatër e rëndësishme biodiversiteti në Evropë me një diversitet të lartë ekosistemesh dhe habitatesh si dhe me një numër të madh llojesh sub-endemike, endemike, të rralla dhe të rrezikuara globalisht prezente në territor. Brenda territorit të saj gjenden ekosisteme detare, zona bregdetare, liqene, lumenj, shkurret me gjelbërim të

përhershëm apo gjetherënëse, pyje gjethegjere dhe pyje halorë, kullota alpine e subalpine dhe livadhe, si dhe ekosisteme të larta malore. Ky diversitet i atribuohet pozicionit gjeografik të vendit si edhe karakteristikave të relievit, tokës, klimatike, hidrologjike dhe gjeologjike. Terreni malor i kombinuar me shkëmbinj të thepisur ka krijuar kushte ideale për mirembajtjen dhe mbrojtjen e një sërë specimesh relikte, disa prej të cilave endemike ose sub-endemike. Gjendja e biodiversitetit prezantohet me të dhënat e monitorimit të llojeve bimore e shtazore dhe rritjen e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura e monitorimin e biodiversitetit brënda tyre. Moment i rëndësishëm në kuadrin ligjor për biodiversitetin është Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 31 datë 20.01.2016 "Për Miratimin e dokumentit të politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit" në këtë dokument të rëndësishëm jepen planet konkrete të veprimit dhe strategjia që do të ndiqet për mbrojtjen e tij. Shqipëria gjendet në pjesën perëndimore të Gadishullit të Ballkanit dhe karakterizohet nga një klimë mesdhetare në ultësira dhe lugina, si dhe kontinentale e të ftohtë në lartësitë veriore dhe lindore. Edhe pse një vend i vogël, Shqipëria, shquhet për larmi të peizazheve e atyre biologjike dhe radhitet ndër vendet me biodiversitet të lartë në Evropë. Sipërfaqja e Shqipërisë, parë në aspektin gjeofizik dominohet nga kodra dhe male në pjesën lindore e veriore dhe zonën e ulët në pjesën perëndimore.



Pjesë me rëndësi në Republikën e Shqipërisë është "Ultësira perëndimore", e cila shtrihet përgjatë zonës bregdetare nga liqeni i Shkodrës në veri deri në qytetin e Vlorës në jug. Veç daljes në det, kjo ultësirë përshkohet nga veprimtaria e lumenjve kryesorë, të cilët përgjithësisht rrjedhin nga lindja në perëndim. Bregdeti shqiptar është 476 km i gjatë, ndërsa deti Adriatik dhe Jon kanë një ndikim të madh mbi klimën, florën dhe faunën e vendit. Zona veriore e Shqipërisë ka një reliev malor dhe karakterizohet nga një diversitet i formacioneve shkëmbore që nga koha e Paleozoikut. Pjesa më e madhe e vendit është zonë malore, ndërsa lartësia ulët duke fi lluar nga lindja në perëndim të vendit dhe kjo përcakton kushtet e klimës, tokës dhe vegjetacionit. i gjithë peizazhi i sotëm është rezultat i zhvillimit gjeologjik gjatë lëvizjeve tektonike dhe neotektonike. Përgjatë bregdetit të vendit ka shumë ekosisteme të rëndësishme në rajonin e Mesdheut, si: lagunat, sistemet ligatinore, dunat ranore, deltat e lumenjve, pyjet dhe hygrophilet. Komunitetet bregdetare dhe infralitorale me origjinë mesdhetare përgjatë bregdetit shkëmbor janë mjaft të ndryshme dhe të ruajtura mirë. Liqenet dhe lumenjtë janë, gjithashtu, të rëndësishme për larminë biologjike dhe peizazheve të vendit.

Të dhëna të përgjithshme për biodiversitetin

Në Shqipëri hasen përafërsisht 7233 grupime bimore (duke përfshirë fieret, kërpurdhat, likenet, myshqet dhe algat) si dhe 5438 lloje të faunës së egër (duke përfshirë shpezët, gjitarët, peshqit, insektet, molusqet etj). Në vendin tonë takohen përafërsisht 32 % e florës evropiane, kurse pyjet e lartë tek ne përbëjnë një habitat të rëndësishëm për gjitarët si psh. ariu i murrmë (*Ursus arctos*), derri i egër (*Sus scrofa*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), si dhe shumë lloje shpezësh.

Komuniteti i pasur i gjallesave detare është një tregues i përbindjes së lartë i ruajtjes dhe cilësisë së këtyre komuniteteve në vendin tonë. Për vite me rradhë janë hasur afërsisht 70 lloje shpezësh ujorë me një popullatë të përafërt prej 180.000 individësh gjatë sezonit dimëror. Në Shqipëri takohen rreth 91 lloje që rrezikohen në shkallë globale dhe këtu futen: pelikani kaçurrel (Pelecanus crispus), bretkosa shqiptare (Pelophylax shqipericus) si dhe bliri (Acipinser sturio), lloje për të cilat vendi ynë është areal me rëndësi të veçantë.

Biodiversiteti në Shqipëri		
Nr.	Grupimet bimore/ shtazore	Sasia e llojeve
1.	Bimë	7233
2.	Fauna e egër	5438
3.	Shpendë ujorë	70
4.	Lloje të rrezikuara në shkallë globale	91
5.	Llojet invazive	47
Totali		12879

Po ashtu kemi 47 lloje invazive që janë rregjistruar deri më tani. Ato u përkasin kryesisht: nematodave (krimbat e rrumbullakët)(1), molusqeve(1), insekteve(21), dekapodëve(2), peshqve(18) si dhe gjitarëve (5). Ndërkohë lidhur me gjendjen e florës, situata është më serioze. Egzistojnë rreth 196 lloje invazive të ciat janë përshtatur dhe kultivuar në mjedisin tonë, si edhe 81 lloje të natyralizuara plotësisht kurse 16 lloje janë bimë të dëmshme të natyralizuara, 11 lloje të mbetura si ish kultura bujqësore, 9 lloje relikte si dhe 38 lloje që përbëjnë lloje të reja të zbuluara, nga ku 41 lloje të introduktuara për të të cilat supozohej dhe ishin rregjistruar si të zhdukura.

Biodiversiteti floristik sipas grupimeve bimore		
Nr.	Gender	Sasia
1.	Llojet invazive	196
2.	Llojet e natyralizuara plotësisht	81
3.	Bimë të dëmshme të natyralizuara pjesërisht	16
4.	Besohet se janë zhdukur	41
Totali		334

Lidhur me florën detare janë rregjistruar 186 lloje. Për më tepër, lista e bimëve të kërcënuara në nivel kombëtar është goxha e gjatë, dhe përfshin 319 lloje, 76 prej të cilave janë në një rrezik të vazhdueshmë, 123 të rrezikuara ndërsa 120 lloje të tjera në përkeqësim, që të gjitha të marra së bashku përballen me një rrezik të lartë në nivel kombëtar. Në Shqipëri egzistojnë rreth 32 lloje bimësh endemike dhe përafërsisht 110 lloje sub-endemike, habitatit i të cilave ndahet ndërmjet Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi, Kroacisë dhe Greqisë.

Flora detare sipas grupimeve bimore		
Nr.	Statusi i kërcënimit	Sasia
1.	Nën rrezik të vazhdueshëm	76
2.	E rrezikuar	123
3.	Në përkeqësim të vazhdueshëm	120
Totali		319


Llojet endemike dhe sub-endemike		
Nr.	Lloji i endemizmit	Sasia
1.	Bimë endemike	32
2.	Bimë sub-endemike	110
Totali		142

Moratoriumi i gjuetisë i vendosur me ligjin Nr. 7/2014 “Per ndalimin e gjuetisë në Republikën e Shqipërisë” deri në vitin 2016 dhe i shtyre për një periudhë të dytë deri në vitin 2021 ka bërë të mundur shtimin e numrit të një sere specieve të faunës së eger, kryesisht 59 llojet që kanë qenë objekt gjuetie.

Vitin e fundit të dhenat e sondazheve dhe monitorimit vitin e kaluar tregojnë:

- Praninë e zogjve shtegtarë në afërsi të bregdetit, gjë që tregon se ekziston paqe dhe është eliminuar në një masë të madhe gjuetia e paligjshme kushtëzuar afërsimin e tufave të këtyre specieve në bregdet;
- Praninë e disa specieve si shqiponja e ndotur e Madhe (*Aquila clanga*, *Clanga c.*) në Divjakë, ose pelikani kacurrell (*Pelecanus sp.*) në Velipojë, specie që nuk ishin raportuar për vite në këto zona;
- Prania e shumtë e specieve të shpendëve shtegtarë është shtuar si rezultat i vendosjes në ligatinat në zbatim të moratoriumit të gjuetisë - ky konstatim tashmë është verifikuar nga kryerja e dy regjistrimeve të specieve migratore të dimrit në shkurt 2016 dhe janar 2017;
- Përveç zogjve shtegtarë, llojet e tjera të faunës së eger siç janë gjitarët e mëdhenj kanë një prioritet në rritje të pranishmësi të tyre të konfirmuar nga prania e tyre në kamerat e bllokimit të vendosura për të identifikuar speciet e rralla të kërcënuara, siç janë rrezet ose vëzhgimet, shoqata të specializuara mjedisore në kuadrin e donatorëve projekte të financuara. Regjistrimi Ndërkombëtar i Rendit të Zogjve (IËC) është një program ndërkombëtar që ka filluar në Shqipëri që nga viti 1993 (me një numër të kufi zuar të ekspertëve dhe fushave kryesore në studim). Në tre vitet e fundit, 2016, 2017 dhe 2018, Regjistrimi u krye me mbështetjen e Projektit Natyror (Programi IPA i BE) dhe me pjesëmarrjen e OJQ-ve dhe ekspertëve të fushës dhe stafit të AKZM-se. Nga të dhenat e grumbulluara rezultoi se numri i zogjve në vitin 2019 është rreth 50% më i lartë se në vitin 2016.

Censusi shpendeve dimerues	2016	2017	2018	2019
Nr i individeve	98564	165268	139069	146395



Vendi ynë ka nivel të ulët të emetimit të karbonit nga industritë, trafiku, dhe burimet e tjera ndërkohë që mbulesa e tokës mbizotërohet nga veçetacioni duke na radhitur ndër vendet me nivel të lartë të sekuestrimit të karbonit nga ekosistemi natyror. Bregdeti Adriatik i Shqipërisë ka një potencial të mirë për mbrojtje nga rreziku i erozionit; kjo zonë kombinon një nivel të

lartë të mbrojtjes nga erozioni me një ndjeshmëri të lartë për erozionin për shkak të shpateve, tokave të ndjeshme dhe reshjeve erozive të kombinuara me përdorimin intensiv të tokës nga njerëzit (Schulp et al., 2012). Në mënyrë të ngjashme, zonat bregdetare, ligatinat dhe përmytjet paraqesin një mundësi të mirë për mbrojtje nga përmytjet përgjatë vijës bregdetare të Shqipërisë dhe lumenjve të shumtë. Ofrimi i shërbimeve: Diversiteti i lartë i ekosistemeve dhe specieve në Shqipëri siguron një gamë të gjerë të produkteve natyrore që kanë një vlerë të konsiderueshme ushqyese dhe/ose ekonomike. Zonat malore janë veçanërisht të rëndësishme për mbledhjen e bimeve të egra (Schulp et al., 2012). Ndër speciet me vlerë të lartë ekonomike, mund të gjenden 300 specie bimore medicinale dhe aromatike, 40 specie bimore foragjere, 50 bimë të njohura për prodhimin e mjaltit, 70 bimë të kultivuara.

Bimet aromatike mjekesore që grumbullohen		
Nr.	Statusi	Sasia
1.	Lloje aromatike-mjekesore	300
2.	Lloje foragjere	40
3.	Lloje për prodhimin e mjaltit	50
4.	Kultura bujqesore	70
Totali		460

Të dhëna për speciet e kërcënuara dhe të mbrojtura të florës

Në VKM-në Nr. 31, datë 20.1.2016 për “Miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për mbrojtjen e Biodiversitetit”, përfshihet aneksi 4, titulluar “LISTA E KUQE E FLORËS SHQIPTARE E PROPOZUAR OSE PRANUAR NGA IUCN”, me këtë përmbajtje:

N/R	Scientific name	IUCN status
16	<i>Stipa mayeri</i> Martinovsky	EN B2ab(iii) Propozuar
17	<i>Tulipa albanika</i> Kit Tan & Shuka CR	CR B2ac(i,iv) Propozuar
18	<i>Festucopsis serpentini</i> (C.E Hubb) Melderis	LC Propozuar
19	<i>Crocus acardicus</i> Kosanin	LC Propozuar
20	<i>Gentiana panchata</i> L.	LC Pranuar
21	<i>Leontopodium alpinum</i> Cass	LC Pranuar
22	<i>Rhamnus intermedius</i> Steud. & Hochst	LC Pranuar
23	<i>Scilla albanica</i> Turill	NT Propozuar
24	<i>Sesleria wettsteinii</i> Dorfl & Hayek	DD Propozuar
25	<i>Sideritis scardica</i> Griseb.	NT Pranuar
26	<i>Solenanthes Albanica</i> Degen & Baldacci	EN B1ab(v)+2ab(v) Pranuar



SHPJEGIMI I KATEGORISË SË RREZIKUT SIPAS IUCN-SË

CR	Rrezik kritik	Lloji është në rrezik të afërt zhdukjeje në natyrë
EN	Rrezikuar	Lloji përballet me një rrezik tejet të lartë zhdukjeje në natyrë
VU	Vulnerabël	Lloji përballet me një rrezik të lartë zhdukjeje në natyrë
NT	Gati i kërcënuar	Lloji nuk plotëson asnjë kriter që do ta kategorizonte që rrezikon zhdukjen, por a të ngjarë ta bëjë në të ardhmen
LC	Shqetësim i vogël	Nuk ka reziqe të tanishme të identifikueshme për llojin
DD	Të dhëna të pamjaftueshme	Ekziston informacion i pamjaftueshëm për të bërë një vlerësim të reziqeve të këtij lloji
LR/cd	Shqetësim më i ulët/varur nga ruajtja	Llojet të cilat kanë qenë fokus i programeve të ruajtjes dhe mund të jenë zhvendosur në një kategori me rrezik më të lartë nëse ai program do ndërpritej
LR/nt	Rrezik më i ulët/gati i kërcënuar	Llojet të cilat janë pranë klasifikimit si vulnerabël, por nuk janë objekt i programeve të ruajtjes
LR/lc	Rrezik më i ulët/shqetësimi më i ulët	Llojet për të cilët nuk ka reziqe të identifikueshme

SPECIET E KËRCËNUARA DHE TË MBROJTURA TË FLORËS

N/R	Scientific name	Kërcënuar Po/Jo	Mbrojtur Po/Jo	Shënime/Statusi i mbrojtjes
1	<i>Aesculus hippocastamun</i> (Gështenja e kalit)	Po	Po	NT
2	<i>Anacamptis palustris</i> (Jacq.) R.M. Bateman (Anakamptë moçalesh)	Po	Po	LC
3	<i>Galanthus reginae-olgae</i> Orph & Pridgeon & Chase (Boçëbore e mbretëreshës olga)	Po	Po	VU
4	<i>Caldesia parnassifolia</i> (L.)Parl. (Gjethë parmasi)	Po	Po	LC
5	<i>Carex markgrafii</i> Kiik.(Presje e Margrafit)	Po	Po	VU
6	<i>Calcihcum macedonicum</i> Kosanin (Lulepreshi)	Po	Po	EN
7	<i>Dactylorhiza cordigera</i> (Daktilrhizë kordigerë)	Po	Po	LC
8	<i>Festuca galicicae</i> Horvat ex Markgr. - Dann	Po	Po	EN
9	<i>Fritillaria graeca</i> Boiss. (Fritilare greke)	Po	Po	DD
10	<i>Fritillaria gussichiae</i> (Degen & Doerfler)Rix	Po	Po	DD
11	<i>Ophrys bertolonii</i> Moretii	Po	Po	LC
12	<i>Ophrys insectifera</i> L. (Ofris isektmbartës)	Po	Po	LC
13	<i>Marsilea quadrifolia</i> L. (Marsile katërgjethëse)	Po	Po	LC
14	<i>Ramonda serbica</i> Pancic (Ramondë e serbisë)	Po	Po	LC
15	<i>Salvinia natans</i> (L) All (Selvinie pluskuese)	Po	Po	LC
16	<i>Stipa mayeri</i> Martinovsky	Po	Po	EN
17	<i>Tulipa albanica</i> Kit Tan & Shuka CR (Tulipani shqiptar)	Po	Po	CR
18	<i>Festucopsis serpentini</i> (C.E Hubb) Melderis (Festukops i serpetinës)	Po	Po	LC
19	<i>Crocus scardicus</i> Kosanin (Shafranii i sharrit)	Po	Po	LC
20	<i>Gentiana punctata</i> L.(Gencilinë pikaloshë)	Po	Po	LC
21	<i>Leontopodium alpinum</i> Cass	Po	Po	LC
22	<i>Rhamnus intermedius</i> Steud. & Hochst	Po	Po	LC
23	<i>Scilla albanica</i> Turrill (Boçkë shqiptare)	Po	Po	NT
24	<i>Sesleria ättesteinii</i> Dorfi & Hayek (Pirë e Vetshtajnit)	Po	Po	DD
25	<i>Sideritis scardica</i> Griseb. (Siderit i Sharrit)	Po	Po	NT
26	<i>Solanthus Albanica</i> Degen & Baldacci (Solenantë e Shqipërisë)	Po	Po	EN

Pyjet

Pyjet janë pasuri natyrore me rëndësi jetike me shtrirje në të gjithë botën, duke u bërë kështu një e mirë efektive pa dallim ndarje kufiri. Pyjet zënë rreth 1/3 e sipërfaqes së tokës, me rreth 4 miliard ha, duke pësuar humbje gjatë viteve. Një pjesë e konsiderueshme e sipërfaqes pyjore shtrihet në Evropë me rreth 180 milionë ha, duke e bërë një nga rajonet më të pasura me pyje, me më shumë se 40% të tokës të mbuluar prej tyre. Në rajonin e Ballkanit, sipërfaqja është 30 milion ha, e cila përbën 23% të sipërfaqes totale të rajonit. Sipërfaqja pyjore në Shqipëri është rreth 1 milion ha, duke zënë rreth 36% të sipërfaqes së vendit, me një mesatare prej 0.36 ha/banor. Kjo shifër është relativisht mesatare krahasuar me vendet e tjera të rajonit, ku Mali i Zi e ka më të lartën me 0.9 ha/banor, Kroacia me 0.44 ha/banor dhe Serbia me 0.3 ha/banor. Volumi i lëndës drusore i përlogaritur është rreth 55 milion m³, me një rënie prej 20 milion m³ nga viti 2005, duke ulur kështu cilësinë e pyjeve tona dhe duke na karakterizuar si një “vend i pasur me pyje të varfër”. Në vitet e fundit, pyjet kanë zënë një vend gjithmonë në rritje në axhendën politike dhe prioritetet e qeverisjes, duke kuptuar rëndësinë e pyjeve për cilësinë e jetës, zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit dhe ekuilibrat natyrorë. Sipas struktues fondit pyjor përbëhet nga 36% trungishte, 28% cungishte dhe 36% shkurre. Nga të dhënat e INSTAT rezulton se 14% e sipërfaqes së fondit pyjor zihet nga pyjet halore (ku 9% është pishë e zezë, 1% bredh dhe 4% halorë të tjerë). Pjesa më e madhe e sipërfaqes së fondit pyjor përkatësisht 50% zihet nga fletorët (16% ah, 29% lis, 0.17% plepa dhe pjesa tjetër nga fletorët e tjerë). Ndërsa 36% zihet nga shkurret (ku shkoza ka 12.6% të sipërfaqes, maret 9% dhe shkurret e tjera 14.23%). Sipas klasave të moshës kemi 22% trungishte me moshë mbi 100 vjet, 6% cungishte me moshë mbi 40 vjet dhe 30% shkurre me moshë mbi 20 vjet. Vihet re që si pasojë e mbishfrytëzimit, vendi ynë karakterizohet nga pyje me moshe relativisht të re. Vëllimi i llogaritur për të gjithë sipërfaqen pyjore është rreth 55 milion m³ lëndë druri në këmbë, rreth 84% e vëllimit drusor është përqëndruar në pyjet e lartë, afro 10% në pyjet e ulët dhe 6% në shkurre.

Rrjeti Kombëtar i Zonave të Mbrojtura mjedisore

Në Republikën e Shqipërisë, zonat e mbrojtura janë shpallur, me VKM – të përkatëse, bazuar në Ligjin nr.8906 “Për Zonat e Mbrojtura”, datë 06.06.2002, (të ndryshuar) dhe me hyrjen në fuqi të ligjit 81/2017, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”. I gjithë sistemi i zonave të mbrojtura, që përfshin aktualisht 18% të territorit të vendit, është përcaktuar sipas kritereve të IUCN –së, në gjashtë kategori kryesore:


Kategoritë e Zonave të Mbrojtura dhe sipërfaqet respektive

Nr.	Emërtimi i kategorisë së zonës së mbrojtur	Nr.	Kategoria	Sip. në Ha
1	Rezervat Strikt Natyror/Rezervat Shkencor	2	I	4 800
2	Park Kombëtar	14	II	230,707. 2558
3	Monument Natyre	723	III	3 470.0
4	Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror	25	IV	169,275. 42
5	Peizazh i Mbrojtur	6	V	97,333. 639
6	Zonë e Mbrojtur e Burimeve Natyrore të Menaxhuara/me përdorim të shumësishtë	4	VI	18, 245.0
	Totali	776		523,831. 31

Rrjeti kombëtar i zonave të mbrojtura mjedisore përfaqësohet nga numri i përgjithshëm i zonave të mbrojtura që është 776 (duke përfshirë edhe monumentet e natyrës), dhe zë një sipërfaqe prej më shumë se 523,831 hektarësh ose rreth 18 % të territorit të Shqipërisë. Në këtë shifër përfshihen edhe territoret bregdetare, si dhe zona detare e Sazan-Karaburunit.

Rritja e sipërfaqes së zonave të mbrojtura është bërë në mënyrë të konsiderueshme që nga strategjia e plani i veprimit të biodiversitetit, të vitit 2000. Duke nisur nga viti 2005 numri i zonave të mbrojtura është rritur më shumë se dy herë, nga 5% në më shumë se 18 %. Harta dhe të dhënat kryesore për ZM-të janë paraqitur respektivisht në anekset 8 dhe 9. Rrjeti aktual i zonave të mbrojtura përfshin 119.401 ha sipërfaqe bregdetare dhe 13.261 ha sipërfaqe detare. Zona e parë detare e mbrojtur në Shqipëri është shpallur në prill të vitit 2010, Parku Kombëtar Detar Karaburun-Sazan. Në listën Ramsar të ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, si habitate ujore me rëndësi për shpendët e ujit janë: 1) Laguna e Karavastasë; 2) Kompleksi ligatinor i Butrintit; 3) Liqeni i Shkodrës dhe Kompleksi ligatinor i lumit Buna; dhe 4) liqenet Zona e Prespës, e shpallur si zona e 4-t Ramsar në Shqipëri, me VKM-në nr. 489, datë 13.6.2013. Shtojca 10 tregon vendndodhjen e zonave Ramsar në hartën shqiptare. Konventa për ligatinat hyri në fuqi për Shqipërinë, më 29 shkurt të vitit 1996. Shqipëria aktualisht ka 4 zona të përcaktuara si ligatina me rëndësi ndërkombëtare, me një sipërfaqe prej 98.181 hektarësh. Zona e Liqenit të Prespës, duke përfshirë dhe Liqenin e Ohrit u propozua, në vitin 2013, si Rezerva e Parë Biosferike për Shqipërinë. Këshilli Internacional i Koordinimi të Programit të UNESCO-s në një seancë të mbajtur në Jönköping-Suedi, më 11.6.2014 (biosfera dhe njeriu) miratoi propozimin për të quajtur rajonin e Ohrit dhe të Prespës si një rezervë ndërkufi tare biosferë. Vlen për t’u theksuar sic vihet re dhe nga grafiku i mëposhtëm se në përdorimin e territorit për Zonat e Mbrojtura mbizotërojnë ekosistemet pyjore, vecanërisht në Parqet Kombëtare që gëzojnë statusin e shkallës së dytë të mbrojtjes. Pyjet te konsideruara si shfaqja me e larte e biodiversitetit zene rreth 45% te gjithe territorit.

Grafiku i përdorimit të territorit për të gjitha kategoritë e ZM




Burimi i informacionit: *Raporti i gjendjes se mjedisit per vitin 2019, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombetare e mjedisit (Faqja Zyrtare).*

Përshkrimi i zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti përfshirë edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj.


Sipërfaqja që prek projekti i propozuar, nuk ben pjese ne zone te mbrojtur. Ky informacion, eshte gjeneruar nga gjeoportali shteteror: asig.gov.al dhe portali e-Planifikim.

Nga verifikimet paraprake me informacionet që disponojme, është identifikuar se nuk preken zona të mbrojtura. Distanca që ruan projekti i propozuar, me zonën e mbrojtur të rajonit është mbi 3.43 km larg Parkut Kombëtar "Mali i Dajtit" në kufirin me të afërt të saj. Ndërsa në lidhje me monumentet natyrore, në zonën në vlerësim, është identifikuar monumenti natyror "Gryka e Murdharit", ku sipas Njoftim Fituesit, një pike nga koordinatat e projektit të propozuar ndodhet në brendësi të sipërfaqes së monumentit. Në këtë rast është propozuar që shfrytëzimi i karrierës të jete vetëm në zonën A, për arsye të mos cenohet dhe të mos preket monumenti natyror.

Imazh satelitor i zones dhe distances që ruan projekti me zonën e mbrojtur të rajonit.



Imazh satelitor i zones dhe distances qe ruan projekti me monumentin natyror te rajonit sipas gjeoportali shteteror: portali e-Planifikim



Per informacion me te sakte, zhvilluesi, ose institucionet aprovue se te projektit, mund te paraqesin kerkese per verifikim prane AKZM per verifikime me te detajuara dhe me te sakta.

INFORMACION PËR NDËRVEPRIMIN NË MJEDIS
SHFRYTËZIMI I MINERALIT GUR GËLQEROR, OBJEKTI "SKUTERRE", ZONA MINERARE NR.318/1
(ISH LEJA MINERARE NR, 1206), SKUTERË, KRRABË, TIRANË

Monumentet Natyrore të Qarkut Tiranë. (Sipas VKM-së 303, date 10.05.2019)

QARKU TIRANE			
Dafina e Kalase se Turres	E ruan	KAVAJE	E mire
Plazhi i Carines(Gjiri i Forsikulit)	E ruan	KAVAJE	E mire
Karsti ne gipsin e mengjajve	E ruan	KAVAJE	E mire
Shpella karstike ne gjips	E ruan	KAVAJE	E mire
Guret ne Rrjesht	E ruan	KAVAJE	E mire
Burimi Sulfuror i Fliballijes	E ruan	RROGOZHINE	E mire
Bokërrimat e Mustafa Koçajt	E ruan	TIRANË	E mire
Gryka e Skoranës	E ruan	TIRANË	E mire
Shpella e Zezë	E ruan	TIRANË	E mire
Shpella e Valit	E ruan	TIRANË	E mire
Karsti i Malit me Gropa	E ruan	TIRANË KLDS	E mire
Gryka e Murdharit	E ruan	TIRANË	E mire
Shkalla e Tujanit	E ruan	TIRANË	E mire
Bokërrimat e Mnerit	E ruan	TIRANË	E mire
Rrapi i Kranës	E ruan	TIRANË	E mire
Rrapi i Prishës	E ruan	TIRANË	E mire
Rrapi i Ndroqit	E ruan	TIRANË	E mire
Foleza e Bardhorit	E ruan	KAVAJE	E mire
Fosilet Detare te Thartorit	E ruan	RROGOZHINE	E mire
Burimet e Kripura te Golemasit	E ruan	KAVAJE	E mire
Ujvara e Përroit të Kecit	Propozim MN	Tirane	E mire
Rrapi i Kom Ka	Propozim MN	Tirane	E mire
Rrapi i Zall Dajtit	Propozim MN	Tirane	E mire

RRJETI I ZONAVE TË MBROJTURA NË SHQIPËRI

MINISTRIA E MJEDISIT						VITI 2014-JANAR	
Nr.	Kategoria	Qarku	Rrethi	Emëri i ZM	Miratimi	Nr.ZM	Sipërf. Ha
1	I	Kukës	Tropojë	Lumi i Gashit	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	3,000.0
2	I	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Kardhiq	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1,800.0
SHUMA I Rezervat Strikt Natyror/Rezervat Shkencor - Kategoria I (RSN)						2	4,800.0
3		Shkodër	Shkodër	Thethi	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	2,630.0
4	II	Dibër	Dibër	Lura	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1,280.0
5	II	Vlorë	Vlorë	Llogara	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1,010.0
6	II	Korçë	Korçë	Bredhi i Drenovës	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1,380.0
8	II	Kukës	Tropojë	Lugina e Valbonës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	8,000.0
9	II	Durrës	Krujë	Qafë Shtamë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	2,000.0
10	II	Dibër	Mat	Zall Gjoçaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	140.0
11	II	Korçë	Korçë	Prespa	VKM nr. 80, datë 18.02.1999	1	27,750.0
12	II	Vlorë	Sarandë	Butrinti	VKM nr.134, datë 20.02.2013	1	9,424.4
13	II	Tiranë,Durres		Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006	1	29,216.9
		Tirane	Tirane	Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006		26,772.7
		Durres	Kruje	Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006		2,444.2
14	II	Fier, Tiranë		Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007	1	22,230.2
		Fier	Lushnjë	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		19,411.1
		Fier	Fier	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		2,074.5
		Tirane	Kavaje	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		744.6
15	II	Elbasan, Diber		Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008	1	33,927.7
		Elbasan	Librazhd	Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008		33,760.1
		Diber, Kukes	Bulqize	Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008		167.6
16	II	Gjirokastrë, Korce		Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008	1	34,361.1
		Permet	Permet	Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008		33,165.3
		Korce	Kolonje	Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008		1,195.8
17	II	Vlore	Vlore	Karaburun-Sazan	VKM nr.289, date 28.04.2010	1	12,428.0
	II	Berat, Elbasan		Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012	1	24,723.1
18	II	Berat	Berat	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		8,398.4
		Berat	Strapar	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		15,045.8
		Elbasan	Gramsh	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		1,278.9
SHUMA II Park Kombetar - Kategoria II (PK)						15	210,501.4
19	III	Shqipëri	Shqipëri	BioMonumente Nr.	VKM nr.676, datë 20.12.2002	348	0.0
20	III			GjeoMonumente Nr.	VKM nr.676, datë 20.12.2002	398	0.0
	III			ShumaBio&Gjeo Nr.		746	0.0

**INFORMACION PËR NDËRVEPRIMIN NË MJEDIS
SHFRYTËZIMI I MINERALIT GUR GËLQEROR, OBJEKTI “SKUTERRE”, ZONA MINERARE NR.318/1
(ISH LEJA MINERARE NR, 1206), SKUTERË, KRRABË, TIRANË**

21	III	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Bredhi i Sotirës	VKM nr.102.datë 15.01.1996	1	1,740.0
22		Gjirokastrë	Gjirokastrë	Zhej	VKM nr.102.datë 15.01.1996	1	1,500.0
23	III	Vlorë	Delvinë	Syri i Kaltër	VKM nr.102.datë 15.01.1996	1	180.0
24	III	Dibër	Dibër	Vlashaj	VKM nr.102.datë 15.01.1996	1	50.0
				Shuma MonNatyre Nr.		4	0.0
				Totali MonNatyre Nr	VKM nr.676.datë 20.12.2002	750	0.0
	SHUMA III	Monument Natyre - Kategoria III (MN)					3,470.0
25	IV	Vlorë	Vlorë	Karaburun	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	20,000.0
26	IV	Korçë	Devoll	Cangonj	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	250.0
27	IV	Berat	Skrapar	Bogovë	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	330.0
28	IV	Korçë	Korçë	Krastafillak	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	250.0
29	IV	Elbasan	Librazhd	Kuturman	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	3,600.0
30	IV	Fier	Fier	Pishë Poro	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	1,500.0
31	IV	Lezhë	Lezhë	Berzanë	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	880.0
32	IV	Fier	Fier	Levan	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	200.0
33	IV	Berat	Berat	Balloll	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	330.0
34	IV	Elbasan	Elbasan	Qafë Bushi	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	500.0
35	IV	Durrës	Durrës	Rrushkull	Urdhër MB nr.2.datë 26.12.1995	1	650.0
36	IV	Vlorë	Delvinë	Rrëzomë	VKM nr.102.datë 15.01.1996	1	1,400.0
37	IV	Kukës	Has	Tej Drini Bardhë	VKM nr.102.datë 15.01.1996	1	30.0
38	IV	Korçë	Kolonjë	Gërmenj-Shelegur	VKM nr.102.datë 15.01.1996	1	430.0
39	IV	Elbasan	Librazhd	Polis	VKM nr.102.datë 15.01.1996	1	45.0
40	IV	Elbasan	Librazhd	Stravaj	VKM nr.102.datë 15.01.1996	1	400.0
41	IV	Elbasan	Librazhd	Sopot	VKM nr.102.datë 15.01.1996	1	300.0
42	IV	Elbasan	Librazhd	Dardhë-Xhyrë	VKM nr.102.datë 15.01.1996	1	400.0
43	IV	Shkodër	Shkodër	Liqeni i Shkodrës	VKM nr.684.datë 02.11.2005	1	26,535.0
44	IV	Lezhë	Lezhë	Kune-Vain-Tale	VKM nr.432, datë 28.04.2010	1	4,393.2
45	IV	Lezhë	Kurbin	Patok-Fushëkuqe-Ishem	VKM nr.995, datë 03.11.2010	1	5,000.7
46	IV	Diber, Kukës	Diber	Korab-Koritnik	VKM nr.898, datë 21.12.2011	1	55,550.2
			Diber	Korab-Koritnik	VKM nr.898, datë 21.12.2011		20,663.4
			Kukës	Korab-Koritnik	VKM nr.898, datë 21.12.2011		34,886.8
	IV/1	Park Natyror Rajonal					
47	IV/1	Diber	Mat	Liqeni i Ulzez dhe zona perreth tij	VKQ nr.16, date 03.04.2013	1	4,206.0
	SHUMA IV	Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror - Kategoria IV (RNM)				23	127,180.1
48	V	Korçë	Devoll	Nikolicë	VKM nr.102.datë 15.01.1996	1	510.0
49	V	Korçë	Pogradec	Pogradec	VKM nr.80, datë 18.02.1999	1	27,323.0
50	V	Vlorë	Vlorë	Vjosë-Nartë	VKM nr.680, datë 22.10.2004	1	19,738.0
51	V	Shkodër	Shkodër	Lumi Buna-Velipojë	VKM nr.682, datë 02.11.2005	1	23,027.0
52	V	Tiranë, Diber, Elbasan		M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007	1	25,266.4
		Tirane	Tirane	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		13,213.6
		Diber	Mat	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		3,016.7
		Diber	Bulqize	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		9,036.1
	SHUMA V	Peizazh i Mbrojtur - Kategoria V (PM)				5	95,864.4
53	VI	Dibër	Dibër	Luzni-Bulaç	VKM nr.102.datë 15.01.1996	1	5,900.0
54	VI	Korçë	Kolonjë	Piskal-Shqeri	VKM nr.102.datë 15.01.1996	1	5,400.0
55	VI	Lezhë	Mirditë	Bjeshka e Oroshit	VKM nr.102.datë 15.01.1996	1	4,745.0
56	VI	Korçë	Pogradec	Guri i Nikës	VKM nr.102.datë 15.01.1996	1	2,200.0
	SHUMA VI	Zone e Mbrojtur e Burimeve te Natyrore te Menaxhuara - Kategoria VI (ZMBNM)				4	18,245.0
	TOTALI I ZM					16%	799

Sip. Republikës	2,674,800.00	ZM pa Sip.Detare	15.54%	446,799.7
		Sip. Detare, Ha	0.5%	13,261.2
			Karaburun-Sazan	12,428.0
			Butrint	833.2
		Sip. Bregdetare dhe Detare	%/Totalit ZM	25.95%
				119,401.5

Shkurtesat:

a	VKM	Vendim i Keshillit te Ministrave		
b	VKQ	Vendim i Keshillit te Qarkut		
c	MB	Ministria e Bujqesise		
d	ZM	Zone e Mbrojtur		


LISTA E ZONAVE RAMSAR

1	RAMSAR	Fier	Lushnje, Fier	Laguna Karavastase_Pisha Divjakes	VKM nr.413, date 22.08.1994	Nr.Site 781, dt.29.11.1995	20,000.0
2	RAMSAR	Vlore	Sarande	Kanali Çukes-Butrint-Kepl Stillos	VKM nr.531, datë 31.10.2002	Nr.Site 1290, dt.28.3.2003	13,500.0
3	RAMSAR	Shkoder	Shkoder	Liqeni Shkodres-Lumi Bunes	VKM nr.683, datë 02.11.2005	Nr.Site 1598, dt.2.2.2006	49,562.0
4	RAMSAR	Korce	Korce,Devoll	Liqeni i Prespave	VKM nr.489, dt. 13.06.2013	Nr.Site 2151, dt 03.07.2013	15,118.6
	TOTALI				%/Totali Republikës	3.42%	98,180.6

DREJTORIA PYJEVE DHE BIODIVERSITETIT
SEKTORI I BIODIVERSITETIT DHE ZONAVE TË MBROJTURA
Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Tiranë.
www.miedisi.gov.al/

INFORMACION PËR NDËRVEPRIMIN NË MJEDIS
SHFRYTËZIMI I MINERALIT GUR GËLQEROR, OBJEKTI "SKUTERRE", ZONA MINERARE NR.318/1
(ISH LEJA MINERARE NR, 1206), SKUTERË, KRRABË, TIRANË

Zonat e mbrojtura në Republikën e Shqipërisë (Sipas faqes zyrtare të MM)



INFORMACION PËR NDËRVEPRIMIN NË MJEDIS
SHFRYTËZIMI I MINERALIT GUR GËLQEROR, OBJEKTI "SKUTERRE", ZONA MINERARE NR.318/1
(ISH LEJA MINERARE NR, 1206), SKUTERË, KRRABË, TIRANË

Monumentet e Kulturës së Rrethit Tiranë

RRETHI I TIRANËS									
NR.	EMRI I MONUMENTIT	FSHATI	KOMUNA	BASHKIA	RRETHI	KATEG	INSTITUCIONI I SHPALLJES	Nr. VENDIMI	DATA SHPALLJES
1	KALAJA NE QYTETIN E TIRANES			TIRANË	TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
2	KALAJA E DORZES ne fshatin Peze e Madhe	PEZE E MADHE	PEZE		TIRANË	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963
3	KALAJA E VAROSHIT ne bregun e majte te Erzenit, ne kuoten 377, ne fshatin Ndroq, muret e kalase me 10 metra distance rreth tyre.	NDROQ	NDROQ		TIRANË	I	Aprov..Ligj. Nr. 609,dt,24.05.1948	586 4874	17.03.1948 23.09.1971
4	KALAJA ne fshatin Laim	VAQARR	VAQARR		TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
5	KALAJA E PETRELES ne Jug Lindje te Tiranes, ne kuoten 392, duke perfshire gjithë kalane me muret e saj si dhe muret e poshtme qe fillojne nga porta den ater citadeles.	PETRELE	PETRELE		TIRANË	I	Aprov..Ligj. Nr. 609,dt,24.05.1948	586 4874	17.03.1948 23.09.1971
6	KALAJA E TUJANIT ne fshatin Shtish Tufin	Tujan	DAJT		TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
7	KALAJA E PREZES ne fshatin Preze, ne kuoten 136, muret e kalase duke perfshire kullat, porten si dhe gemadnat perrenda	PREZE	PREZE		TIRANË	I	Aprov..Ligj. Nr. 609,dt,24.05.1948	586 4874	17.03.1948 23.09.1971
8	KALAJA E DAJTIT ne reze te malit Dajt		Dajt		TIRANË	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963
9	SHPELLA E PELLUMBASIT	PELLUMBAS	BËRZHITË		TIRANË	I	M.K.R.S.(Drejt. e Trasheg.Kulturore	Nr.prot. 3967	10.10.2002
10	MURET ANTIKE DHE VARRI I PERSHQOPIT ne malin e Petreles, mbi faqen e malit me kuote 592, me nje distance prej 10 metra larg mureve.	PETRELE	PETRELE		TIRANË	I	Aprov..Ligj. Nr. 609,dt,24.05.1948	586 4874	17.03.1948 23.09.1971
11	URA E TABAKEVE ne fillim te rruges "Ali Demi", 25 metra e gjate.			TIRANË	TIRANË	I	Aprov..Ligj. Nr. 609,dt,24.05.1948	586 4874	17.03.1948 23.09.1971
12	URA E BRARIT, 10 m ne Ver-Lindje te Tiranes, mbi lumin e Tiranes, 15 metra e gjate	BRAR	DAJT		TIRANË	I	Aprov..Ligj. Nr. 609,dt,24.05.1948	586 4874	17.03.1948 23.09.1971
13	URA KANAL ne fshatin ZALL-HERR	ZALLHERR	ZALLHER		TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	Urdhëres	08.01.1977
14	KULLA E SAHATIT ne qendren e qytetit, godina me distance 5 metra rreth e perqark.			TIRANË	TIRANË	I	Aprov..Ligj. Nr. 609,dt,24.05.1948	586 4874	17.03.1948 23.09.1971
15	PUSI ME KUPOLE NE QENDER TE FSHATIT PREZE	PREZE		TIRANË	TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	2509/1	30.06.1983
16	RRENOJAT E KISHES SHEN MARISE	LINZE- Sherri	DAJT		TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	68/7	30.05.1970
17	XHAMIA E ETHEM BEUT ne qender te qytetit, godina e rrethuar ne 4 anet me rruge, duke perfshire edhe dy varret			TIRANË	TIRANË	I	Aprov..Ligj. Nr. 609,dt,24.05.1948	586 4874	17.03.1948 23.09.1971
18	TYRBJA E KAPLLAN PASHËS, ne kendin e kryqezimit "28 nentori" me rrugen "Myslym Shyri", godina me nje periferi prej 5 metra rreth e perqark.			TIRANË	TIRANË	I	Aprov..Ligj. Nr. 609,dt,24.05.1948	586 4874	17.03.1948 23.09.1971
19	TYRBJA E NUSES ne fshatin Mullet	MULLET - PETRELE	PETRELE		TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	Urdhëres	08.01.1977
20	TEQEJA E SHEH DYRRIT			TIRANË	TIRANË	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963
21	MOZAIKU NE BLOKUN PARTIZANI ne qytetin e Tiranes			TIRANË	TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
22	GODINA ISH BIBLIOTEKA KOMBETARE Rr.Alqi Kondi,nr.7, lagjia 28 nentori.			TIRANË	TIRANË	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963
23	BANESA E ISH TOPTANASVE (Pasuri Shteti), lagjia "29 nentori", Rr. Myslym Shyri, Nr.11.			TIRANË	TIRANË	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963
24	BANESA E HYSEN KAZANIT. , Rr. Fadil Rada, Nr.22, ne qytetin e Tiranes			TIRANË	TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1883	10.06.1973
25	BANESA E RESHAT PETRELES, ne rrugen e "Barnkadave", Nr.109, ne qytetin e Tiranes			TIRANË	TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	2854 814	08.08.1980 25.10.1980
26	BANESA E SHUAKASVE, Rruga "Virdan Luarasi", Nr.14, ne qytetin e Tiranes			TIRANË	TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1883	10.06.1973

INFORMACION PËR NDËRVEPRIMIN NË MJEDIS
SHFRYTËZIMI I MINERALIT GUR GËLQEROR, OBJEKTI "SKUTERRE", ZONA MINERARE NR.318/1
(ISH LEJA MINERARE NR, 1206), SKUTERË, KRRABË, TIRANË

27	BANESA E BAJRAM UKES (SULEJMAN METES), ne fshatin Brar	BRAR	DAJT	TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	Urdhëres	08.01.1977	
28	BANESA E QAMIL CULLHAJ ne fshatin Surrel	SURREL PRISKE	DAJT	TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	Urdhëres	08.01.1977	
29	BANESA E BAJRAM LAMIT ne fshatin Zall-Bastar	ZALL-BASTAR			I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	Urdhëres	08.01.1977	
30	BANESA E AHMET CUNIT ne fshatin Murize	MURIZE - ZALL-BASTAR	ZALL-BASTAR	TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	Urdhëres	08.01.1977	
31	SHTEPËIA KU KA PASUR QENDREN ORGANIZATA BASHKIMI ne kohën e revolucionit te qershorit, Rruga "Xhoxhi Martini", nr.12, ne qytetin e Tiranës			TIRANË	TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
32	SHKOLLA E MESME PEDAGOGJIKE "17 Nentori", Rruga "Myrteza Kellic", lagja nr.2.			TIRANË	TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	2509/1	30.06.1983
33	BANESË NË RR."TeftaTashko"Nr.42. Paraqet nje variant te zhvilluar te baneses qytetare te gjysmes se dyte te shek XIX.			TIRANË	TIRANË	I	Komiteti i Kulturës dhe Arteve	8	18.12.1987
34	GODINA E PARLAMENTIT TE PARE SHQIPTAR(viti 2000) (Godina e Teatrit te kukullave- viti 1992)			TIRANË	TIRANË	I	Minis. e Kultur. Rinise e Sporteve dhe M.K.R.S(Drejtor.Trasheg.Kultures	79 105	17. 11.1992 28.03.2000
35	KORPUSI QENDROI I ANSAMBLIT qe perben (ISH KINOSTRUADIO) SOT (ALBAFILM Studio)			TIRANË	TIRANË	II	M.K.R.S. (Kabineti i Ministril.)	Urdhër Nr. 202	24.05.2001
36	AKSI KRYESOR DHE QENDRA HISTORIKE E TIRANES			TIRANË	TIRANË	I	Këshilli i Ministrave	180	13.04.2000
37	PALLATI I BRIGADAVE dhe Parku i tij("Ansambel Historik dhe "Zone e Stimuluar"			TIRANË	TIRANË	I	Këshilli i Ministrave	752	11.11.2004
38	UNIVERSITETI I TIRANES ne sheshin "Nene Tereza"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
39	STADIUMI KOMBETAR " QEMAL STAFJA" ne sheshin "Nene Tereza"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
40	BIBLIOTEKA E UNIVERSITETIT ne sheshin "Nene Tereza"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
41	MUZEU ARKEOLOGJIK ne sheshin "Nene Tereza"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
42	PALLATI I KONGRESEVE ne Bulevardin "Deshmoret e Kombit"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
43	AKADEMIA E ARTEVE ne sheshin "Nene Tereza"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
44	SELIA E PRESIDENCËS ne Bulevardin "Deshmoret e Kombit"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
45	KLINIKA MJEKËSORE QEVERITARE ne Bulevardin "Deshmoret e Kombit"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
46	BANESA KOLEKTIVE 5- KAT NE RR."DËSHMORËT E 4 SHKURTIT			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
47	VILA BARDHA NË RRRUGËN "LEKË DUKAGJINI"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
48	AMBASADA ITALIANE RR."LEKË DUKAGJINI"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
49	BANESË TIP VILË NË RR. "ISMAIL QEMALI"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
50	BANESË TIP VILË NË RR. "LEKË DUKAGJINI"NË KRAH TË STADIUMIT "Q.STAFJA"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
51	RADIO TELEVISIONI SHQIPTËR RR. "LEKË DUKAGJINI"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
52	BANESË TIP VILË NË RR. "DËSHMORËT E 4 SHKURTIT, ECRAM.			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
53	BANESA TIP VILË NË RR."DËSHMORËT E 4 SHKURTIT, ISH VILA 31			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
54	BANESË TIP VILË NË RR. "LEKË DUKAGJINI" AMBASADA E MAQEDONISE			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007

INFORMACION PËR NDËRVEPRIMIN NË MJEDIS
SHFRYTËZIMI I MINERALIT GUR GËLQEROR, OBJEKTI "SKUTERRE", ZONA MINERARE NR.318/1
(ISH LEJA MINERARE NR, 1206), SKUTERË, KRRABË, TIRANË

55	BANESE TIP VILE NE RR. "LEKE DUKAGJINI" RESTORANT DUKAGJINI			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
56	BANESE TIP VILE NE RR. "LEKE DUKAGJINI" VILA LOGORECI			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
57	INIMA RR."LEKE DUKAGJINI"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
58	KRYEMINISTRIA- Ne BULEVARDIN "DESHMORET E KOMBIT"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
59	NDËRTESEA E KUVENDIT TE SHQIPËRISË Ne BULEVARDIN "DESHMORET E KOMBIT"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
60	BANKA ARABE ne RR."DONIKA KASTRIOTI"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
61	BANESA TIP VILE RR."DONIKA KASTRIOTI" PAS AGJENSISE ODISEA			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
62	BANESA TIP VILE RR."DONIKA KASTRIOTI", OSCE.			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
63	BANESA TIP VILE NE RR."DESHMORET E 4 SHKURTIT", BANKA BOTËRORE			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
64	BANESA TIP VILE RR."DONIKA KASTRIOTI" REZIDENCA E AMBASADËS ZVICERJANE			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
65	BANESA TIP VILE RR."DONIKA KASTRIOTI" AMBASADA E KOMUNITETIT EVROPIAN			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
66	BANESA TIP VILE NE RR."DESHMORET E 4 SHKURTIT",DELEGACION E KOMISHONIT EVROPIAN			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
67	BANESA TIP VILE (PNUDI) RR. DËSHMORËT E 4 SHKURTIT			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
68	BANESE TIP VILE NE RR. "ISMAIL QEMALI", NË LULISH -TEN PËRBRI PRESIDENCES			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
69	PALLATI I SHALLVARES , Nr.1 RR." DËSHMORËT E 4 SHKURTIT"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
70	PALLATI I SHALLVARES , Nr.2 RR. "DËSHMORËT E 4 SHKURTIT"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
71	PALLATI I SHALLVARES , Nr.3 RR." DËSHMORËT E 4 SHKURTIT"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
72	PARKU " RINIA" NE BULEVARDIN "DËSHMORËT E KOMBIT"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
73	KATEDRALJA E SHEN PALIT NE BULEVARDIN "M.KASHEN"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
74	HOTEL "DAJTI" BULEVARDI "DËSHMORËT E KOMBIT"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
75	GALERIA KOMBËTARE E ARTEVE BULEVARDI "DËSHMORËT E KOMBIT"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
76	KOMPLEKSI NDËRTIMOR RR. "MURAT TOPTANI" Nr.2			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
77	AKADEMIA E SHKENCAVE NE RR."MURAT TOPTANI "			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
78	SALLA E SEANCAVE PLENARE TE KUVENDIT TË SHQIPËRISË RR. ELBASANI			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
79	NAMAZGJAJA NE RR. E ELBASANIT.			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
80	KABINA E PARË ELEKTRIKE DHE SHATERVANI NE RR. "PUNËTORET E RILINDJES".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
81	GODINA E ISH TE PERNDJEKURVE NE RR. E ELBASANIT.			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
82	BIBLIOTEKA KOMBËTARE (FONDI), RR. "PUNËTORET E RILINDJES".			TIRANË	TIRANË	I II	Minis. Kultur.Rinise e Sporteve dhe M.T.K.R.S.(Drejt.Trashëg.Kultur.)	79 362 122	17.11.1992 29.08.2000 05.03.2007
83	GODINA ISH HOSTENI, ne RR. "PUNËTORET E RILINDJES".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007

INFORMACION PËR NDËRVEPRIMIN NË MJEDIS
SHFRYTËZIMI I MINERALIT GUR GËLQEROR, OBJEKTI "SKUTERRE", ZONA MINERARE NR.318/1
(ISH LEJA MINERARE NR, 1206), SKUTERË, KRRABË, TIRANË

84	BANESË TIP VILË , RR. "S.TOPTANI"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
85	MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE,RR. "S.TOPTANI".	ish M.T.K.R.S.		TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
86	BASHKIA E TIRANËS NË "SHESHIN SKENDERBEJ".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
87	MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE; TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT ne RR."DËSHMORET E KOMBIT".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
88	MINISTRIA E BRENDSHME ne BULEVARDIN "DËSHMORET E KOMBIT".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
89	MINISTRIA E MBROJTJES ne BULEVARDIN "DËSHMORET E KOMBIT".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
90	MINISTRIA E BUJQËSISË ne BULEVARDIN "DËSHMORET E KOMBIT".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
91	MINISTRIA FINANCAVE; BULEVARDI "DËSHMORET E KOMBIT".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
92	SELIA E PARTISË SOCIALISTE; SHESHI "SKENDERBEJ"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
93	GJYKATA E LARTË; NË RR."MYSLIM SHYRI"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
94	POSTE TELEGRAFA ne RR. "DËSHMORET E 4 SHKURTIT".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
95	DREJTORIA E BANKËS SË KURSIMEVE; NË RR. "DËSHMORET E 4 SHKURTIT".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
96	BANESA TIP VILË RR. "DËSHMORET E 4 SHKURTIT"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
97	LABORATORI I KRIMINALISTIKËS, RR. "DËSHMORET E 4 SHKURTIT".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
98	PALLATI I KULTURËS; NE "SHESHIN SKENDERBEJ".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
99	BANKA E SHËTËTIT SHQIPËTAR ne "SHESHIN SKENDERBEJ".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
100	SHESHI I TEOQESË; NË RR. E "BARRIKADAVE"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
101	HOTEL TIRANA; RR. "BAJRAM CURRI".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
102	BANESA PETRELA ; RR. "BARRIKADAVE".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
103	BANKA E PARË KOMBËTARE; RR. "BAJRAM CURRI".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
104	QENDRA "VEVE"; BULEVARDI "ZOGU I PARË"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
105	BANESA TIP APARTAMENTI; NË BULEVARDIN "ZOGU I PARË".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
106	ISH ATSH; NË BULEVARDIN "ZOGU I PARË".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
107	PALLATI I HERSHËM ; NË BULEVARDIN "ZOGU I PARË".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
108	SELIA E PARTISË "REPUBLIKANE"; NË BULEVARDIN "ZOGU I PARË".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
109	MATERNITETI NË BULEVARDIN "ZOGU I PARË".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
110	FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS ; NË BULEVARDIN "ZOGU I PARË".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007
111	BANESA TIP VILË ; NE BULEVARDIN "ZOGU I PARË".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturor.)	122	05.03.2007

INFORMACION PËR NDËRVEPRIMIN NË MJEDIS
SHFRYTËZIMI I MINERALIT GUR GËLQEROR, OBJEKTI "SKUTERRE", ZONA MINERARE NR.318/1
(ISH LEJA MINERARE NR, 1206), SKUTERË, KRRABË, TIRANË

112	BANESA TIP VILË NË RR. "ASIM VOKSHI".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
113	ALFA BANK; NË BULEVARDIN "ZOGU I PARË".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
114	HOTEL LONDON (ISH DONIKA); NË BULEVARDIN "ZOGU I PARË".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
115	PALLAT "ALI KELMENDI" NË BULEVARDIN "ZOGU I PARË".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
116	MUZEU HISTORIK KOMBETAR; NE SHESHIN "SKENDËRBEJ".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
117	LIDHJA E SHKRIMTARËVE; NË RR. E "KAVAJËS".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
118	BANESË TIP VILË ;NË RR. "K.KARAFILI".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
119	HOTEL "INTERNACIONAL" NË RR. "K. KARAFILI".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
120	BANESË TIP VILË ; NË RR. E "DURRESIT".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
121	AMBASADA E VATIKANIT ; NË RR. E DURRESIT .			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
122	HOTEL "PARKU"; NË RR. "PUNETORET E RILINDJES".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
123	PALLATI KASMI; NË RR. "PUNETORET E RILINDJES".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
124	KOMUNITETI MYSLIMAN; NË RR. "PUNETORET E RILINDJES".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
125	SELIA E PARTISË SOCIAL-DEMOKRATE.			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
126	VILA TARTARI NË RR. E KAVAJËS			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
127	MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS; NË RR. E "DURRESIT".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
128	PALLATI I HERSHËM; NË RR. E "DURRESIT". (PERBALLË MINISTRISË SË ARSIMIT).			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
129	MINISTRIA E MJEDISIT ;NË RR. E "DURRESIT"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
130	VILË BANIMI (3 KATE) NË RR. E DURRESIT.			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
131	ISH AMBASADA JUGOSLLAVE NE RR. E DURRESIT.			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
132	ISH PASTERIA NË "RR. E KAVAJËS"			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
133	INSTITUTI I KULTURËS POPULLORE NE "RR. E KAVAJËS".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
134	KISHA KATOLIKE NË "RR. E KAVAJËS".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
135	FAKULTETI I GJUHEVE TË HUAJA NE "RR. E ELBASANIT".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
136	SHESHI "AVNI RUSTEMI";			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
137	BLOKU I VILAVE - SHESHI "AVNI RRUSTEMI".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
138	POSTA E VJETER TEK ISH " VEFA"-SHESHI "AVNI RRUSTEMI".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007
139	MEDRESEJA ;NË"RR. E DIBRËS".			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	122	05.03.2007


**INFORMACION PËR NDËRVEPRIMIN NË MJEDIS
SHFRYTËZIMI I MINERALIT GUR GËLQEROR, OBJEKTI "SKUTERRE", ZONA MINERARE NR.318/1
(ISH LEJA MINERARE NR, 1206), SKUTERË, KRRABË, TIRANË**

140	ZONË MUZE-ZONA PERRETH SHTEPISË MUZE KU U FORMUA P.K.SH.DHE ZONA E MBROJTUR (Ansambli i rruges "Formimi i Partise" qe perfshihet midis rrugëve "4 Deshmoret", "Riza Cerova", "Bajram Cumi" dhe "Thanas Ziko" shpallet zone e mbrojtur, ndersa zona perreth shtepise muze ku u formua Partia Komuniste Shqiptare shpallet zone Muze, ne Tirane.	Aprovuar nga Min.Ars. dhe e Kult. me shkr. nr.952/1 DT.23.04.1976		TIRANE	TIRANË	I	KESHILLI I MINISTRAVE	249	01.07.1980	
141	SHTEPJA MUZE KU U THEMELUA P.K.SH. lagjia "8 nentori", rruge "Formimi i Partise".			TIRANE	TIRANË	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963	
142	SHTEPJA MUZE KU U THEMELUA RINIA K.SH. lagjia "Vojo Kushi", Rruge "Reshit Petrolo", Nr.37.			TIRANË	TIRANË	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963	
143	BANESA (MUZE) E HAXHI QAMILIT.	SHARRE	VAQARR		TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	6.02.1979	
144	SHTEPJA KU U MBAJT KONFERENCA E PEZES ne fshatin Peze	PEZE	PEZE		TIRANE	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963	
145	ISH SHTEPJA E DALIP KARAJ ne fshatin Alltati(Baldushk) -KA QENE NJE NGA BAZAT KRYESORETE E.HOXHES DHE TE SHTABIT TE PERGJITHSHEM	ALLTAT - BALDUSHK	BALDUSHK		TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979	
146	SHTEPJA MUZE E AVDULLA KETES. lagjia nr.4, Rruge "Bajram Cumi", nr.133, Tirane				TIRANË	TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	6138/1	31.12.1981
147	SHTEPJA E XHEZMI DELLIT				TIRANË	TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	2854	8.08.1980
148	RRENOJAT E KISHES SHEN MERISE-TUJAN DHE MIRATIMI I ZONES SE MBROJTUR.	BRAR			TIRANE	TIRANË	I	Komiteti i Kulturës dhe Arteve M.T.K.R.S. (MINISTRI)	8 838	18.12.1987 28.08.2008
149	GJURME TE REJA TE KALASE SE TIRANES				TIRANË	TIRANË	I	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturorë.)	652	15.05.2008
150	KALAJA E TIRANES "ZONA ARKEOLOGJIKE" DHE RREGULLORJA E ADMINISTRIMIT TE SAJ.				TIRANE	TIRANË	I	KESHILLI I MINISTRAVE	1197	03.12.2009
151	BANESA KU KA JETUAR FAMILJA E "NENE TEREZËS" ne rrugen e Kavajes	Rr. e Kavajës			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. -Drejt. Trashëg.Kulturorë	115	15/03/2010
152	KRYEGJYSHATA BOTERORE BEKTASHIANE (Sella Tirane)				TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. -Drejt. e Përgjith. e Turizmit dhe e Trashëgimise Kulturorë	236	17.05.2010
153	VARRI I NENES MBRETERESHE. Tirane				TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. -Drejt. e Përgjith. e Turizmit dhe e Trashëgimise Kulturorë	383	16.07.2010


Burimi i Informacionit: Ministria e Kulturës, faqja zyrtare

2. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.

Në afërsi të zonës ku kryhet shfrytëzimi i mineralit gëlqeror nuk ka burime ujore të rëndësishme të identifikuar. Aktiviteti i shfrytëzimit do të kryhet në Qarkun Tiranë, Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Krrabë, Skuterë, zona minerare nr. 318/1 dhe nuk ndodhet në brendësi apo në afërsi të burimeve ujore të rëndësishme si Lumenjtë kryesore, Liqene, Rezervuar apo Zona Bregdetare. Në afërsi të zonës identifikohet Lumi i Zallit të Korres i cili ndodhet në veri-perëndim të sipërfaqes rreth 590.14 m larg në vijë ajrore dhe një rezervuar ujëmbledhës i cili ndodhet në veri-perëndim të sipërfaqes mbi 1.57 km larg në vijë ajrore. Në afërsi të kësaj sipërfaqeje që shfrytëzohet nuk ka as Liqene (Rezervuar), as Dete apo Laguna.



Fragment nga studimi urbanistik i Bashkisë Tiranë Objekti ndodhet në njësinë strukturore KR/15



Cilësia e ujërave në vendin tonë

(Informacione të përgjithshme bazuar në studimin Kombëtar vjetor të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit)

Monitorimi i cilësisë së ujit është i rëndësishëm për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e ujërave, identifikimin e shkaktarëve të ndotjes deri në dhënien e rekomandimeve përkatëse sipas problematikave të identifikuara.

LUMI I ERZENIT Të dhëna të përgjithshme fiziko-gjeografike, klimatike dhe hidrologjike.

Pellgu i lumit të Erzenit shtrihet tërësisht në zonën e mesme të Shqipërisë dhe ka një sipërfaqe prej 853 km². Gjatësia sipas vijës ujëndarëse është 81.8 km, gjerësia mesatare është 10.5 km dhe gjerësia më e madhe 21 km, pjerrësia mesatare është 6 %. Lartësia më e madhe është 1648 m, ndërsa lartësia mesatare e pellgut është 448 m mbi nivelin e detit. Gjatësia e lumit është 109 km. Si rezultat i gjatësisë jo shumë të madhe të pellgut vihen re ndryshime të vogla të sasisë vjetore të rreshjeve nga një rajon në tjetrin. Rreshjet e rëna gjatë dimrit, për periudhën shumë vjeçare, janë 3,3 herë më të mëdha se sa ato që bien gjatë periudhës së verës, kurse sasia e rreshjeve në formë dëbore, si rezultat i lartësisë së ulët mesatare të pellgut, është e vogël. Ato luajnë rol vetëm në pjesën e sipërme të pellgut. Ky lumë dallohet për lëkundshmëri të madhe të rrjedhës së lëngët si në periudhën shumë vjeçare ashtu edhe brenda vitit. Koefi çienti i rrjedhës është 0.66. Prurjet më të pakta 2.27 m³/sek, në Sallmonaj dhe 2.15 m³/sek, në Mullet 2.0 m³/sek ndërsa në Skoranë 1.4 m³/sek. Prurja më e madhe (plota e viti 1946), në Sallmonaj është 1210 m³/sek, në Ndroq 984 m³/sek, Mullet 726 m³/sek dhe në Skoranë 665 m³/sek. Raporti midis

prurjes mesatare vjetore dhe të asaj të periudhës së thatë të vitit për Sallmonaj është 5.8. Ushqimi sipërfaqësor është 69 % të rrjedhës vjetore dhe ai nëntokësor 31 % të saj. Në aspektin klimatik, pellgu i Erzenit bën pjesë në zonën mesdhetare fushore qëndrore, mesdhetare kodrinore qëndrore dhe mesdhetare paramalore veriore. Veprimi i faktorëve kryesorë klimatikë paraqitet i ndryshëm si në shpërndarjen e elementëve përbërës të saj në hapësirë, ashtu edhe në kohë. Si rezultat i ndryshimeve të theksuara të relievit, reshjet kanë larmi të theksuara dhe niveli i tyre arrin 900-1400 mm/vit. Numri i ditëve me rreshje varion rreth 100-130 ditë/vit. Lartësia e shtresës së borës lëkundet 40-80 cm dhe rrallë më shumë që arrin në vende të veçanta deri 1-1.5 m. Bora përfshin periudhën Dhjetor-Mars. Ushqimi kryesor i rjetit hidrografik janë rreshjet e shiut, gjë e cila shprehet edhe në veçoritë e regjimit të rrjedhjes vjetore. Në stinën e verës, prurjet e përrenjve pakësohen aq shumë së një pjesë e tyre thahen plotësisht. Në mvarësi të nënzoneve, temperaturat absolute luhaten nga -25°C në 35°C.

Ndërtimi gjeologjik i pellgut.

Formacionet gjeologjike, që ndërpriten nga rrjeti hidrologjik i lumit të Erzenit, u përkasin zonave tektonike të Mirditës, Njësisë së Ostrenit, Nënzonës së Krastës, Zonës Kruja, Zonës Jonike dhe Ultësirës Adriatike.

Në zonën e Mirditës takohen këto formacione:

- Formacioni vullkano-sedimentar i Anizinianit (diabaze, mikrodiabaze, verlite, spilite bajamore deri tufe vitroklastike, gëlqerorë të kuq me amonite)
- Formacionet karbonatike të Triasikut të Sipërm-Jurasikut të Poshtëm

Në njësinë e Ostrenit:

- Flishi i Titonian-Cenomanianit

Në nënzonën e Krastës takohen këto formacione:

- Depozitimet fl ishore të Kretës së Poshtme
- Formacionet karbonatike të Kretës së Sipërme
- Depozitimet e Kretë-Paleogjenit (argjila, alevrolite dhe ranorë me ndërshtresa gëlqerorësh)

Në nënzonën e Krujës takohen këto formacione:

- Formacionet karbonatike të Kretës së Sipërme
- Formacionet karbonatike dhe flishore të Paleogjenit

Në nënzonën Jonike takohen këto formacione:

- Formacionet fl ishore të Oligocenit të Mesëm dhe të Sipërm
 - Depozitimet e Miocenit (argjila, konglomerate, ranorë, mergele, gëlqerorë litotamnikë, gëlqerorë dhe argjila merglore)
 - Depozitimet mollasike të Miocenit të Sipërm të cilët vendosen mbi bazamentin e zones Kruja dhe asaj Jonike (të njëjtat formacione të përshkruara në pellgun e Ishmit).
 - Depozitimet e shkriфта të Kuarternarit, si ato të Pleistocenit ashtu edhe ato të Holocenit.
- Këto të fundit përbëjnë aluvionet që ndërtojnë shtratin e Erzenit dhe terracën e parë të tij.

Stacioni Pëllumbas

Tabela 12. Të dhënat e matjeve në stacionin e Pëllumbasit, lumi i Erzenit.

Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Er1	Er1
Data e kryerjes së matjeve	26 Prill, 2019	06 Shtator, 2019
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	-	-
Temperatura e ujit	16.00 C	17.30 C
Numri i nënseksioneve të ndara	10	7
Sasia e prurjeve	2.818 m ³	1.207 m ³
Rezja hidraulike R _u	0.27 m	-
Moti	Muaji Prill deri ditën e matjeve ka patur vranësira dhe reshje atmosferike mesatare deri të dobëta me kthjellime të përkohëshme. Dita e matjes është kohë e vranët dhe kthjellime.	Gjatë javës së fundit ka qënë kohë me vranësira dhe reshje të përkohëshme atmosferike. Dita e matjes kohë e mire me vranësira të pakta.

Stacioni Sallmone

Tabela 13. Të dhënat e matjeve në stacionin e Sallmones, lumi i Erzenit.

Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Er3	Er3
Data e kryerjes së matjeve	26 Prill, 2019	6 Shtator, 2019
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	13.0 m	13.5 m
Temperatura e ujit	19.0 0 C	24.80 C
Numri i nënseksioneve të ndara	6	5
Sasia e prurjeve	7.66 m ³	4.079 m ³
Rezja hidraulike R _u	0.64 m	-
Moti	Muaji Prill deri ditën e matjeve ka patur vranësira dhe reshje atmosferike mesatare deri të dobëta me kthjellime të përkohëshme. Dita e matjes është kohë e vranët dhe kthjellime.	Gjatë javës së fundit ka qënë kohë me vranësira dhe reshje të përkohëshme atmosferike. Dita e matjes kohë e mire me vranësira të pakta.

LUMI I ISHMIT

Të dhëna të përgjithshme fiziko-geografike, klimatike dhe hidrologjike.

Lumi i Ishmit formohet nga bashkimi i ujrave të lumit të Tiranës, Tërkuzës dhe Zezës. Si zanafillë ka lumin e Tiranës që rrjedh nga shpatet perëndimore të Malit me Gropa ku derdhen edhe burimet e Selitës. Këto burime kanë një prurje mesatare shumëvjeçare prej Q=520 litra/sek. Në lumin e Tërkuzës, derdhen burimet e Bovillës me një prurje mesatare shumëvjeçare prej Q=380 litra/sek. Sipërfaqja e përgjithëshme e pellgut ujëmbledhës është 673 km², duke përfaqësuar kështu sipërfaqen më të vogël në krahasim me pellgjet e lumenjve të tjerë të Shqipërisë. Lartësia mesatare e pellgut është 357 m. Gjatësia e lumit të Tiranës është rreth 65 km. Në kilometrin e 37-të bashkohet me lumin e Tërkuzës dhe në kilometrin e 43-të ai bashkohet me lumin e Zezës. Të tre degët ujore që formojnë rrjedhën e lumit Ishëm, në pjeset e sipërme të tyre janë përrrenj malorë, me rrjedhje të rrëmbyeshme. Prurja mesatare shumëvjeçare e Ishmit në det është afërsisht 30 m³/ sekondë që i përgjigjet një moduli prej 32 l/sek/km². Koeficienti i rrjedhjes për të gjithë pellgun hidrografik është 0,68, prurja e ngurtë 45,3 kg/ sek, turbullira 2167 gr/m³ dhe moduli i rrjedhjes së aluvioneve pezull 2 167 ton/km² në vit. Mineralizimi i ujrave kryesisht me karbonate është mesatar, rreth 354 mg/litër. Lumi i Ishmit, ushqimin kryesor e ka nga rreshjet në formë shiu. Në mvarësi të kushteve të ushqimit rrjedha ujore gjatë periudhës shumëvjeçare ndryshon nga një vit në tjetrin, po ashtu, vërehen ndryshime të theksuara edhe brenda vitit. Rrjedha e periudhës së lagët të vitit (Tetor-Maj) përfaqëson 87-92 % të vëllimit të përgjithshëm të kësaj rrjedhe, ndërsa rrjedha e periudhës së thatë (Korrik-

Shtator), 3-9 %. Prurjet më të mëdha në kohë plotash ndryshojnë nga 450 m³/s në lumin e Tiranës në Shupal, në 1230 m³/s në Urën e Gjolës dhe 1220 m³/s në Sukth Vendas. Sipas rajonizimit klimatik të Shqipërisë, ky rajon përfshihet pjesërisht në nënzonën qendrore të Zonës mesdhetare kodrinore dhe pjesërisht në nënzonën qendrore të Zonës mesdhetare fushore, e cila zë dhe pjesën më të madhe të këtij rajoni. Në njësinë fushore rreshjet lëkundet nga 920-1200 mm. Numri i ditëve me rreshje lëviz ndërmjet 85100 ditëve, ndërsa temperatura mesatare vjetore është 15-160 gradë C (lit 18). Shirat nuk kanë karakter të rrëmbyeshëm dhe bora nuk është dukuri e përvitshme. Periudha me ngrica është e shkurtër dhe ditët e akullta janë të pakta, 15-30 ditë në vit kryesisht në muajt Janar e Shkurt. Gjatë stinës së ftohtë mbizotërojnë erërat juglindore dhe vënde-vënde ato veriperëndimore, ndërsa gjatë stinës së ngrohtë kudo mbizotërojnë erërat veriperëndimore. Në njësinë kodrinore, rreshjet kanë një shpërndarje të njëtrajtëshme 1100-1300 mm. Temperatura mesatare vjetore lëkundet ndërmjet 11-13° C, në pjesët e ulëta deri në 150 C, ndërsa në muajt e ngrohtë mesatarisht 24-25° C. Bora zë 5-15 % të rreshjeve vjetore dhe nuk i kalon 10-17 ditë me rreshje në vit në funksion të lartësisë hipsometrike. Numri i ditëve me rreshje shiu-bore gjatë vitit lëkundet ndërmjet 95-105 ditëve.

Ndërtimi gjeologjik i pellgut.

Stratigrafia e luginës së lumit të Ishmit është e lidhur ngushtë me stratigrafinë e zonës Kruja. Dallojmë këto formacione gjeologjike nga më të vjetrat deri tek më të rejat:

- Depozitimet karbonatike të Kretës së Sipërme.
- Flishi i Paleogjenit (ndërthurje alternative ranorësh, argjilash dhe alevrolitesh)
- Depozitimet mollasike të Miocenit të Sipërm të cilët vendosen mbi bazamentin e zonës Kruja
 - Suita laramane e Mamlit (konglomeratë dhe ranorë që dora-dorës kalojnë në pako të fuqishme argjilash laramane me thjerëza e ndërshtresa ranorësh e konglomeratësh)
 - Suita e Priskës (gëlqerorët litotamnikë ose ranorët litotamnikë)
 - Suita e Skuterrës (kryesisht argjilo- alevrolitore me qymyrbajtje)
 - Suita ranorike e Ibës (ranorë masive që formojnë pako të fuqishme dhe më pak nga argjila e alevrolite)
 - Suita e Mëzezit (kryesisht argjila me thjerëza ranorësh e me shtresa të shumta qymyri)
- Depozitimet e shkrifta të Kuarternarit si ato të Pleistocenit ashtu edhe ato të Holocenit.

Këto të fundit përbëjnë aluvionet që ndërtojnë shtratin e degëve të Ishmit dhe terracën e parë të tij.

Stacioni Brar, lumi i Tiranës

Tabela 10. Të dhënat e matjeve në stacionin Ura e Brarit, lumi i Tiranës.

Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	T1	T1
Data e kryerjes së matjeve	30 Prill, 2019	27 Shtator, 2019
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	14.2 m	14.35 m
Temperatura e ujit	16.50 C	18.50 C
Numri i nënseksioneve të ndara	8	8
Sasia e prurjeve	3.397 m ³	0.464 m ³
Rezja hidraulike R _h	0.34 m	-
Moti	Ka patur kohë të paqëndrueshme me vranësira dhe rreshje shiu gjatë 10 ditëshit të fundit. Dita e matjes është kohë me vranësira dhe rreshje shiu.	Gjatë javës së fundit ka qënë kohë me vranësira dhe rreshje të përkohëshme atmosferike. Dita e matjes kohë me vranësira dhe rreshje.

Stacioni Salme-Shetaj, lumi i Ishmit

Tabela 11. Të dhënat e matjeve në stacionin Salme-Shetaj, lumi i Ishmit.

Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Ish3	Ish3
Data e kryerjes së matjeve	30 Prill, 2019	27 Shtator, 2019
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	10.1 m	10.4 m
Temperatura e ujit	17.60 C	19.70 C
Numri i nënseksioneve të ndara	9	8
Sasia e prurjeve	10.607 m³	4.442 m³
Rezja hidraulike R _h	0.71 m	-
Moti	Ka patur kohë të paqëndrueshme me vranësira dhe reshje shiu gjatë 10 ditëshit të fundit. Dita e matjes është kohë me vranësira dhe reshje shiu.	Gjatë javës së fundit ka qënë kohë me vranësira dhe reshje të përkohëshme atmosferike. Dita e matjes kohë me vranësira dhe reshje.

BASENI ISHEM – ERZEN

Lumi i Tiranës përshkon pjesën veriore të Tiranës, në zonën e quajtur Bregu i Lumit aty ku formohet kufiri administrativ verior i Tiranës i cili e ndan nga Komuna Paskuqan.

Lana derdhet në Lumin e Tiranës, i cili kalon përmes qytetit të Tiranës. Ai buron në pjesën perëndimore të Qafës së Priskës dhe ka një gjatësi prej 29 km. Në hyrje të Tiranës, Lana rrjedh në një kanal të sistemuar betoni dhe pastaj bashkohet me lumin e Tiranës në verilindje të Bërxullës nga ku formohet Lumi i Ishmit.

Lumi Ishem rrjedh përmes Shqipërisë Qendrore me një gjatësi rreth 74 km i cili formohet nga bashkimi i Lumit të Tiranës, delta e të cilit ndodhet në Kepin e Rodonit.

Lumi Erzen buron nga Mali me Gropa, 25 km nga lindja e Tiranës, pranë Shëngjergjit dhe derdhet në Gjirin e Lalezit në veri të qytetit të Durrësit.

Monitorimi i këtij baseni realizohet në 10 stacione kampionimi në të gjithë gjatësinë e tij. Vlerësimi i cilësisë së ujërave të basenit është kryer bazuar në vlerat limite të parametrave të Direktivës Kuadër të Ujit.

Oksigjeni i tretur


Vlerat mesatare të ekspeditave të realizuara janë paraqitur në formë grafike si vijon ku shihet qartë që stacionet të cilat janë të varfëra në oksigjen janë stacionet e Ishmit.



Lumi Erzen paraqitet të jetë me ujëra të pasur me oksigjen duke u klasifikuar në Klasën I – Gjendje e lartë.

Nevoja Biokimike per oksigjen


Nevoja Biokimike për oksigjen është sasia e oksigjenit të tretur që nevojitet të konsumohet nga organizmat biologjike aerobike të cilat ndodhen në sasinë e kampionit në shishen e pajisur me oxitop. Inkubimi në 20 °C realizohet për 5 ditë ku vlera e matur shprehet në mg O/liter. Ky parametër është i rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së ujërave të lumenjve, tregues i shkallës së ndotjes.



Tejkalim të vlerës limite për parametrin Nevoja biokimike për oksigjen kemi në stacionet T2 – Kamëz poshtë urës , L2 – Ish Dogana Kashar ku vlera mesatare e ekspeditave të realizuara është 75 mgO/l një vlerë shumë e lartë që dëshmon një shkallë ndotjeje shumë të lartë duke e klasifikuar në Klasën V – Gjendje e keqe ku duhet të merren masa të menjëhershme (> 18 mg/l). Tejkalim të normës kemi edhe në tre stacionet e monitorimit të Lumit Ishëm ku gjendja paraqitet me një ndotje të lartë e klasifikuar në Klasën IV – Gjendje e varfër. Lumi Erzen paraqitet të jetë nën normën e lejuar në Klasën III – gjendje e moderuar.

Permbajtja e amoniakut

Përcaktimi i përmbajtjes së amoniakut në kampione uji i përcaktuar me metodën spektrometrike është parametër kryesor i klasifikimit në klasa të cilësisë së ujerave sipas DKU. Grafiku paraqet të dhënat mesatare të ekspeditave të realizuara.



Në stacionet e monitoruara kemi tejkalim të vlerës limite për përmbajtjen e amonjakut në stacionin T2 – Ura Kamëz, L2 – Lanabregas me vlerën mesatare më të lartë 17.1 mg/l duke e klasifikuar këtë stacion në klasën V – Gjendje e keqe, si dhe në të tre stacionet e Ishmit të cilat klasifikohen në Klasën V – Gjendje e keqe. Stacioni Er2 – Ura e Beshirit Ndroq me një vlerë mesatare të përmbajtjes së amonjakut 0.45 mg/l – e cila ndodhet në kufirin e Klasës III –Gjendje e moderuar.


Permbajtja e nitriteve

Sic vihet re edhe në grafikun e mëposhtëm, përmbajtja e nitriteve është nën normën e lejuar në të gjitha stacionet e këtij baseni.



Permbajtja e nitrateve

Përmbajtja e nitrateve në të gjitha stacionet e monitoruara rezulton në vlera më të ulëta se norma e lejuar.



Permbajtja e fosforit


Referuar të dhënave mesatare vjetore, vlerësojmë se kemi tejkalim të vlerës limite të përmbajtjes së orto – fosfateve në stacionin T2 – Ura e Kamzës, L2 – Lanabregas në vlerën 1.14 mg/l duke e klasifikuar këtë stacion në Klasën V – Gjendje e keqe. Tejkallim të vlerës limite kemi edhe në të tre stacionet e Ishmit duke e klasifikuar këtë lum në klasën e IV – Gjendje e varfër. Stacionet e Lumit Erzen nuk ka patur përmbajtje të fosforit.



Permbajtja e fosforit total

Referuar vlerave mesatare të ekspeditave të realizuara vlerësojmë së stacioni L2 – Lanabregas tejkalojn vlerën limite të klasës së III duke klasifikuar Lanabregasin në Klasën V – Gjendje e keqe. Gjithashtu, është vlerësuar se ka prani të fosforit total në të tre stacionet e monitorimit të Lumit Ishëm por në vlerën kufi duke e klasifikuar këtë lum në Klasën III – Gjendje e moderuar.

Permbajtja e fosforit total



Duke marrë në konsideratë të gjithë parametrat, vlerësojmë se në stacionet e referencës lumenjtë janë të pastër, ndërsa duke kaluar afër zonave të banuara impakti i shkarkimeve urbane të cilat derdhen direkt të patrajuara sjell këtë klasifikim me një ndotje të lartë.

Baseni Ishëm – Erzen klasifikohet në Klasën V – Gjendje e keqe.

Burimi i informacionit: Raporti i gjendjes së mjedisit për vitin 2019, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (Faqja Zyrtare).

3. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.

3.1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR

Ky Raport i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, është hartuar bazuar në legjislacionin mjedisor për VNM dhe ka për qëllim që të identifikojë, parashikojë, vleresojë dhe parandalojë ose minimizojë ndikimin në mjedis të projektit të propozuar.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

- a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II të ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011;
- b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I të ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011;

Objektivat afatshkurter të VNM janë:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore të projektit të propozuar;
- Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrë të duhur dhe me efikasitet;
- Siguron që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vendodhjes së projektit.
- Siguron që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të Disponueshme të teknologjisë së propozuar për tu aplikuar.
- Identifikon masat e duhura për zvogelimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit të propozuar;
- Mundeson informimin e vendimtarësve, duke gjykuar në miratimin ose jo të projektit dhe kushteve që duhet të vendosen në aktin e miratimit.

Objektivat afatgjate të VNM janë:

- Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut;
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/dëmtimet e pakthyeshme të mjedisit;
- Ndikon në mbrojtjen e burimeve natyrore, peisazhet e natyrës dhe komponentet perberes të ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale-ekonomike të projektit
- Ndihmon në realizimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit.

Përshkrim i përmbledhur të kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin:

- **Ligji Nr 10431 datë 09.06. 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".**
- **Ligji Nr 10440 datë 07.07. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", i ndryshuar.**
- **Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit", i ndryshuar.**
- **Ligji Nr. 10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".**
- **Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja".**
- **Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit".**
- **Ligji Nr.10266 për disa ndryshime në ligjin 8897 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.**
- **Ligji Nr. 10304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë"**
- **Ligji Nr. 5/2016 datë 4.2.2016 "Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë".**
- **Ligji Nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar**

- Vendim Nr.1189, Datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të Monitorimit të Mjedisit" .
- Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 "Per menaxhimin e zhurmave".
- Vendim Nr. 313, dt. 09.05.2012 "Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis".
- Vendim Nr. 538 dt.26.05.2009 "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla te tjera".
- Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendim-marrjen mjedisore".
- Vendim i KM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja".
- Vendim Nr. 686, date 29.07.2015 Per zhvillimin e procedures se VNM-se.
- Vendim i KM Nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"
- Vendim i KM Nr. 435, date 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë"
- Vendim i KM Nr. 741, datë 9.9.2015 "Për miratimin e formës, rasteve të kthimit dhe mënyrës së llogaritjes të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e investimit në veprimtarinë minerare"
- Vendim i KM Nr. 1353, date 10.10.2008 "Per procedurat e zvogelimit te siperfaqes e te vellimit te fondit pyjor".
- Vendim i KM Nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse"
- Vendim i KM Nr. 402, date 30.06.2021 "Per Miratimin e Katalogut te mbetjeve"
- Vendim i KM Nr. 229, datë 23.4.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit"
- Udhezim Nr. 8, dt.27.11.2007 "Per nivelet kufi te zhurmave ne Republikën e Shqiperise".

Sqarim:

Bazuar ne Ligjet e mbrojtjes se mjedisit dhe ligjit Nr. 52/2020, datë 30.04.2020, ky projekt perfshihet ne listat e aktiviteteve, te cilat duhet te pajisen me leje mjedisore te tipit B. Ky Informacion per Nderveprimin ne Mjedis, sipas kerkesave dhe detyrimeve ligjore, mund te paraqitet ne Agjencine Kombetare te Mjedisit per t'iu nenshtruar procedures se thelluar te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (faza e pare - Njoftimi), sipas kerkesave te Ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 "Per VNM", i ndryshuar. Ky raport hartohet ne perputhje te plote me kerkesat e VKM Nr. 686, date 29.07.2015 "Per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis", gjithashtu hartohet per te informuar institucionet e mbrojtjes se mjedisit mbi ndikimet ne mjedis te aktivitetit.

3.2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT


Ky raport i Nderveprimit ne Mjedis, hartohet me kerkese te subjektit “ANCHOR INVESTMENTS” Sh.p.k, me NIPT: L71421016I, me seli ne Tirane, Rruga “Ibrahim Rugova”, Nd.40, H.8, Ap.45, Njesia Administrative nr.5, 1019 dhe me përfaqësuese ligjore Z. Albi Shyti. Objekti i vleresimit te ketij raporti eshte aktiviteti i shoqerise ne fushen e shfrytezimit te mineralit Gelqeror ne objektin e ndodhur ne zonen minerare 318/1, Skuterë, Njesia Administrative Krrabë, Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë.

Subjekti “ANCHOR INVESTMENTS” Sh.p.k eshte pajisur me “Njoftim Fituesi” nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, me Nr. 4574/2 Prot, date 26.07.2021 per shfrytezimin e mineralit gelqeror ne zonen minerare 318/1.

Perkatesisht sipas Njoftim Fituesit koordinatat e karrieses jane paraqitur si me poshte ne harten topografike, por duke qene se njera nga pikat bie ne zone te mbrojtur eshte rishikuar dhe propozuar qe shfrytezimi i karrieres te jete vetem ne zonen A, me koordinatat e paraqitura si me poshte.

Ne kete faze subjekti ka plikuar per Njoftim, për zhvillimin e procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (faza e pare) dhe pajisje me Deklaratë Mjedisore në vijimësi për aktivitetin, per te aplikuar me pas dhe për t'u pajisur me Leje të re Mjedisore tipi B për aktivitetin e shfrytëzimit të mineralit gur gëlqeror.

Aktualisht gjendja mjedisore e kesaj zone paraqitet mjaft e mire, pasi eshte nje zone e pa zhvilluar dhe e pa shfrytezuar nga ana e burimeve natyrore nga subjekte te tjera. Si rrjedhoje, subjektit i duhet qe paralelisht me punimet e shfrytezimit te kryeje edhe rehabilitimin e siperfaqes se demtuar nga ai vete. Madje ne perfundim te shfrytezimit, te rehabilitoje te gjithë siperfaqen e demtuar, e cila mund te kete sherbyer si infrastrukture rrugore, sheshe depozitimi, ambjente ndihmese, etj. Siperfaqja qe do te shfrytezohet me karriere sipas projektit te paraqitur eshte ne total 0.102 km². Kapaciteti i projektuar i shfrytezimit per kete aktivitet eshte 260.000 m³/vit. Per shfrytezimin e mineralit Gelqeror eshte menduar te perdoret skema e shfrytezimit ne qiell te hapur, pra me karriere, ne siperfaqe. Radha e shfrytezimit do te jete nga larte poshte.



Nomeklatura e Hartës në shkallë 1:10000 (K-34-100-B-d-2)





Tabela: Koordinatat e Projektit


Koordinatat e sipërfaqes se shfrytezimit sipas Njofitim Fituesit					
Koordinatat ne sistemin Gaus Kruger			Koordinatat ne sistemin KRGJSH		
Nr.	E (Y)	N (X)	Nr.	E (Y)	N (X)
1	4415010	4566283	1	498727.17	4565655.12
2	4414750	4566450	2	498465.03	4565819
3	4414920	4566720	3	498632.14	4566090.82
4	4415200	4566540	4	498914.03	4565914.15
Koordinatat e sipërfaqjes te ZONES A qe do te shfrytezohet					
1	4414867.596	4566374.467	1	498583.46	4565744.91
2	4415010	4566283	2	498727.17	4565655.12
3	4415200	4566540	3	498914.03	4565914.15
4	4415102.347	4566602.777	4	498815.72	4565975.63
5	4415036.936	4566535.07	5	498751	4565907.23
6	4415032.182	4566530.312	6	498746.38	4565902.47
7	4414998.372	4566497.593	7	498712.92	4565869.43
8	4414988.043	4566482.1	8	498702.84	4565854.03
9	4414972.696	4566461.967	9	498687.72	4565833.73
10	4414952.983	4566442.217	10	498668.26	4565813.43
11	4414930.713	4566425.403	11	498646.14	4565796.35
12	4414923.111	4566420.825	12	498638.58	4565791.87
13	4414922.867	4566420.533	13	498638.16	4565791.45
14	4414911.512	4566408.022	14	498627.1	4565778.71
15	4414890.565	4566389.585	15	498606.23	4565760.13
16	4414867.596	4566374.467	16	498583.46	4565744.91

Pamje e objektit minerar te subjektit “ANCHOR INVESTMENTS” ne Skuterrë





INFORMACION PËR NDËRVEPRIMIN NË MJEDIS
SHFRYTËZIMI I MINERALIT GUR GËLQEROR, OBJEKTI "SKUTERRE", ZONA MINERARE NR.318/1
(ISH LEJA MINERARE NR, 1206), SKUTERË, KRRABË, TIRANË



Vazhdimi i punimeve të shfrytëzimit me qiell të hapur, gjithashtu, favorizohet nga:

- Renia e formacioneve, që ndertojnë pakon produktive në drejtim të tillë që lejojnë zhvillimin normal të shkalleve dhe elementeve të tyre pa sjelle kushtezime teknike.
- Eksperiencia e shfrytëzimit të viteve të kaluara ka treguar se elementet e shtruarjes së formacioneve gelqerore dhe karakteristikat gjeomekanike të tyre favorizojnë kendet e mëdha të skarpatave dhe nuk sjellein asnjë rrezik rreshqitje.
- Fortesia e pershtateshme e mbulesave deluvionale, të cilat mund të germohen me lehtësi me mjete të mekanizuara pa patur nevojën e përdorimit të Lendeve Plasese
- Hidrogarfia e zonës, në përgjithësi dhe në pjesë të caktuara për leje minerare në veçanti, e cila nuk patuar dhe nuk pritet të krijojë probleme për shfrytëzimin e vendburimit, mbasi sipërfaqja është plotësisht e drenuar dhe nuk ka probleme ujërash dhe burimesh të pranishme në të.
- Hidrologjia, burimet e ujërave, proskaj apo vepra ujore të ndërtuara etj, të cilat nuk janë të pranishme në zonën e shfrytëzimit dhe për rreth saj.
- Koeficienti i vogël i zbulimit, në saj të të cilit nuk ka nevojë për sipërfaqe të mëdha të depozitimit të perhershëm ose të perkohshëm të sterileve
- Sasia e sterileve që do të dalin nga karriera është e mjaftueshme për të bërë rehabilitimin e sipërfaqes së shfrytëzimit pas përfundimit të afatit të shtyrjes së lejes

Prodhimi që mendohet të realizohet në zonën minerare	260.000 m ³ /vit
Sasia e prodhimit që do të përpunohet	260.000 m ³ /vit
Vlera e rehabilitimit ekonomik (IRR=.....%)	50.8 %
Sipërfaqja	0.102 km ²

Elementet e karrieres

Kendi i skarpates së shkalleve dhe transheve .

Duke pasur parasysh treguesit treguesit gjeomekanik të formacioneve është llogaritur kendi i skarpates duke përdorur metodat kompjuterike të cilat së bashku me rezultatet e tyre paraqiten në tabelën e mëposhtme

Vlera e kendit të skarpates e llogaritur sipas metodave

Nr	Metoda	Rezultati i kendit	Koeficienti i sigurisë
1	FELENIUS	72°	1.24
2	BISHOP	74°	1.36
3	SPENCER	73°	1.2
4	RAULIN	74°	1.13
5	JANBU	75°	1.14
6	MORGENSTERN E PRICE	74°	1.16

Nga llogaritjet e mësipërme del se kendi i skarpates është nga $\phi = 70^\circ - 75^\circ$, ndërsa koeficienti i sigurisë, nga $K_s = 1.13 - 1.36$

Bazuar në llogaritjet e mësipërme, janë bërë llogaritje shtesë të kendit të skarpates duke marrë në konsideratë dhe praninë eventuale të ujit të rreshjeve. Pas llogaritjeve të mësipërme kendi i skarpates është pranuar 73°

Koeficienti i sigurisë është pranuar 1.2 (rekomanduar nga literatura perkatese për një kohë ekspozimi nën 15 vjet)

Kendi i skarpates në pjesët me perkulje konvekse të shkalleve (cepat e karrieres) është pranuar 4-6 grade me i vogël.

Per te siguruar nje qendrueshmeri normale te skarpatave dhe shesheve te punes parashikohet qe sheshet e punes te kene nje pjeresi prej 1-2% ne drejtim te transhese kryesore duke siguruar rrjedhen normale te ujrave dhe duke parandaluar ngopjen e formacionve argjilore nga uji.

Variantet e hapjes se metejshme te vendburimit, argumentimi dhe zgjidhja e menyres se hapjes se vendburimit

Ne studimin e varianteve te hapjes se vendburimit jane mare ne konsiderate :

- Kuota e poshtem e rruges ekzistuese +700m
- Kuota e sipërme e zones se shfrytezimit +780m
- Parametrat gjeometrike te zones se shfrytezimit
- Shperndarjen e rezervave te nxjerreshme ne shkalle ne raport me sasine e pergjitheshme te rezervave
- Pjeresine e mesatare, me te madhe dhe me te vogel te siperfaqes se objektit dhe asaj jashte kufijve te saj.
- Mundesine e lidhjes me rruge te pjeses se sipërme te karrieres mbi +900m me rruge ne brendesi te zones se shfrytezimit.

Sistemi i shfrytezimit, treguesit tekniko-ekonomike te tyre

Elementet e sistemit te shfrytezimit qe parashikohen te perdoret ne kete objekt jane:

- Lartesia e shkalles se karrieres eshte 10m
- Gjeresia e sheshit te punes nga 8-12 m ne 20-40-150m
- Kendi i skarpatës se shkalles 70-73°
- Gjeresia e shesheve perfundimtare te shkalleve 4 m
- Kapaciteti ditor 1080 m³
- Bartja dhe transporti i mekanizuar;
- Rezimi i i gurit gelqeror me perdorimin e lendes plasese
- Rendimenti per dite pune efektive te punonjesve direkte 150-220 m³/dp
- Rendimenti per dite pune efektive te punonjesve gjithsej 130-180m³/dp

Ne zgjedhjen e sistemit te shfrytezimit jane mare parasysh faktoret e meposhtem:

- Menyra e ngarkimit dhe transportit te sterilit
- Menyra e kryerjes se punimeve te zbulimit
- Menyra e ngarkimit dhe transportit te gurit gelqeror ne brendesi te karrieres dhe jashte saj

Rradha dhe drejtimi i shfrytezimit de grafiket perkates

a) Rradha dhe drejtimi i shfrytezimit

Drejtimi i shfrytezimit. Drejtimi shfrytezimit te objektit do te jete pergjithesisht nga ana jugelindore drejt asaj veriperendimore per ne kufi duke u zhvendosur ne te dy drejtimet Veri Lindja dhe Juge Perendim deri ne kufijte ekstreme te zones se shfrytezimit.

Shfrytezimi do te filloje ne afersite profilit III-III, ose ne zonen midis profilit III-III dhe IV- IV dhe do te zhvillohet ne te dy drejtimet drejt ekstermeve te zones se kerkuar per shfrytezim.

Ojentimi i pergjithshem i shkalleve do te jete sipas izohipseve te terenit

Hyrja e rruges ne zonene shfrytezimit ne kuoten +750 m behet ne zonen nga ekstremi veri perendimor ne profilin I-I.

Per realizimine sasise se prodhimit te parashikuar ne projektin e shfrytezimit te ketij objekti eshte parashikuar qe shfrytezimi te kryhet ne tre shkalle.

Per krijimin e kushteve per nje pune normale ne karriere eshte parashikuar qe ne vitin e pare te behen sistemime ne shkallen +750m, ate +7800m dhe ate +770m.

Kjo eshte bere per arsye te krijimit te sheshit te depozitimit te përkohshëm të sterileve. Zona ka siperfaqe te madhe dhe jo e gjitha do ti nenshtrohet shfrytezimit. Ekstremi veriperendimor i zones nga kufiri i saj deri ne kuoten +750 nuk do ti nenshtrohet shfrytezimit dhe parshikohet te perdoret;

- Per depozitimin e mbeturinave sterile dhe dherave te ndryshme apo mbetjeve vegjetale qe do te perdoren per rehabilitimin e zones se shfrytezuar.
- Per zvillimin e rrugeve lidhese te zone nga kuota +750 ne ne zbritje deri ne kouten e poshteme +700qe parashikohet te jete kuota e fundit e shfrytezimit subjekti duhet te hap fillimisht vetem rrugen per depozitimin e mbetjeve te ndryshme te sterileve qe eventualisht dalin gjate pastrimit te sierfaqes para shfrytezimit.

Kapaciteti nxjeres i minieres, regjimi i punes, ndersa ne dite, dite ne muaj, ose vit, Grafiku i punimeve te zbulimit dhe grafiku i podhimit per gjithe minieren.

Kapaciteti Prodhues

Prodhimi realizuar nga shfrytezimi i ketij vendburimi ne zonen e kerkuar do te kete si destinacion perdorimin e tij ne industrine e ndertimit dhe te sistemit rrugor apo elementeve te tjere te infrastructures te rajonit edhe me gjere dhe do te perdoret si stabilizant ne forme te gureve te prodhuar direkt nga karriera dhe te materialit te perpunuar si rere, granil apo çakull si dhe prodhimin e gelqeres apo te industrise se çimentos. Per kete arsye, ne varesi te tregut te studjuar dhe te prithshem, subjekti parashikon nje prodhim vjetor nga 20000 duke u rritur gradualisht ne 50 mije, 200 mije deri ne rreth 260000 m³/vit.

Regjimi i punes

Per realizimin e prodhimit te parshikuar karriera do te punoje 12 muaj, 22 dite ne muaj me nje dhe dy nderesa ne dite dhe me 6-7 ore /dite pune.

Per vitin e pare te aktivitetit te saj karriera do te punoje me nje intensitet me te larte per hapjen e rruges nga niveli +750m per ne shkallen e sieprme +780m, realizimin e zbulimit, sistemimet e ndryshme dhe te prodhimit.


Grafiku i zbulimit dhe prodhimit

Zbulimi tesor i karrieres deri ne kuoten +700 parashikohet te realizohet hap pas hapi, duke filluar nga shkalla e pare nga larte +780m ne drejtim zbrites. Zbulimi konsiston ne pastrime te ndryshme te barit dhe shkurreve, si dhe vende vende ku ka depozitim te dherave. Ne 15 vitete e lejes se shfrytezimit parashikohet te kryhet zbulimi i plote te karrieres deri ne shkallen +700m. Ne vitin e pare parashikohet te realizohet nje zbulim prej rreth 2750 m³ dhe nje prodhim prej 20 000 m³. Ne kete sasi nga hapja e rruges parashikphen te prodhohen rreth 15000 m³ gelqerore. Vellimi i pergjithshem i zbulimit dhe prodhimit ne vitin e pare duke bere zbulim ne shkallet +780m dhe pjeserisht ne ate +770 parashikohet te jete 22750 m³. Vellimi ditor, per vitin e pare, do të jetë 100 m³/dite, ndersa per vitet e tjera 1080 m³/dite. Ne tabelat e meposhteme jepet parashikimi i prodhimit ne vite ne shkalle:


Parashikimi i prodhimit te gurit gelqeror ne m³ ne shkalle, ne vite sipas ofertes se paraqitur ne Komisionin e Vleresimit te Ofertave ne pjesemarrje per te fituar te drejten per leje minerare

Nr	Shkalla	Volumi , masiv, m ³	Volumi i shkrifet, m ³	Viti 1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	SHUMA
1	780	13830	19362	9360															9360
2	770	81950	114730	10640	20000	30000	50000	4090											114730
3	760	150250	210350		10000	20000	30000	50000	100000	350									210350
4	750	223750	313250				20000	60000	100000	100000	33325								313325
5	740	294750	412650					85910	60000	150000	116740								412650
6	730	355300	497420							9650	109935	150000	100000	100000	27835				497420
7	720	408500	571900									60000	100000	100000	100000	100000	100000	11900	571900
8	710	440500	616700									50000	60000	60000	10000	10000	10000	15000	620000
9	700	455600	637840												32165	60000	60000	98100	250265
SHUMA		2424430	3394202	20000	30000	50000	100000	200000	260000	260000	260000	260000	260000	260000	260000	260000	260000	260000	3000000

Planimetria e karrieres



Planimetria e karrieres ne gjendje te rehabilituar



Ndikimet negative ne karakteristikat fizike te zones se projektit

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi "Ndotësi paguan"
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 "Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" dhe VKM Nr. 686, date 29.07.20015 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis" dhe ka si synim idnetifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f) Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- g) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.:

Sa me siper vleresimi i ndikimeve ne mjedis do te vleresoje:

- Ndikimet ne ajer
- Ndikimet ne ujera
- Ndikimet ne toke
- Ndikimet ne biodiversitet (mjedisi biologjik)
- Ndikimet ne mjedisin social-ekonomik
- Ndikimet qe shkaktojne ndryshimet klimatike

Ndikimet ne ajer (Cilesia e ajrit, zhurmat, vibrimet, peizazhi.)

Impakti:

Gjate aktivitetit ne karrriere do te ngrihen pluhura dhe ne rast se nuk aplikohet lagia me uje gjate sezonit me thatesire, mund te krijohet nje imazh i pakendshem. Shkarkimet e gazeve te mjeteve motorike do te jene burime te shkarkimeve te gazeve te demshme per ajrin, por jo ne nivele te larta shqetesuese. Zhurmat jane normale per nje aktivitet te tille, por qe nuk do te jene shqetesuese per zonat e banuara, pasi ato ndodhen ne largesi. Kryesisht zhurmat shkaktohen nga germimet e masivit te shkembit, nga sharrat, nga çekiçet pneumtaike, nga transporti, germimet e tokes shkembore, nga prerjet e pemeve ne rast se do te jete e nevojshme, etj. Gjate punimeve do te kete demtim te rendesishem te peizazhit te zones, nga germimet dhe humbja e bimesise,

ndryshimi i relievit, heqja e shtreses aktive të tokës dhe humusit. Sheshi i parkimit dhe makinerite gjithashtu do të kenë efekt në peizazhin e zonës. Dëmtimi i bimesisë, ndikon në uljen e cilësisë së ajrit.

Masa parandaluese:

Aplikimi i lagjes së kantierit/karrierës me ujë gjatë sezonit me thatësirë për të reduktuar pluhurat. Kufizimi i orarit të punës vetëm gjatë ditës për të reduktuar zhurmat. Përdorimi i mjeteve dhe materialeve cilësore e eficientë. Monitorim i cilësisë së ajrit gjatë fazës së punimeve. Ky projekt ndikon në mjedisin biologjik të zonës, kryesisht nga dëmtimi i sipërfaqes pyjore dhe krijimit të një peizazhi jo të këndshëm për zonën. Këto efekt mund ta reduktojnë vetëm zbatimi i një projekti rehabilitimi të detajuar të sipërfaqes së shfrytëzuar të karrierës. Maskimi i germimeve dhe skarpatave me bimesi të lartë.

Ndikimet në ujëra (Ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore.)

Impakti:

Ky aktivitet nuk shoqërohet me shkarkime në ujë, pasi nuk përdor ujë në procesin e punës, nuk prodhon ujë, nuk prek burimet ujore të zonës.

Masa parandaluese:

Të orientohen ujërat e shiut, duke mos krijuar erozion dhe të mos krijohen pellgje uji në mjedisin e karrierës. Të orientohen ujërat nëntokësore që mund të dalin në sipërfaqe gjatë germimeve, duke mos lejuar rrjedhjen e tyre në mënyrë të pakontrolluar në mjedisin e zonës. Nëse do të shihet e nevojshme, të ndërtohet edhe një vaske dekantimi e filtrimi të ujit të kantierit me qëllim pastrimin e tij. Makinerite të mos shkarkojnë substanca të dëmshme në mjedisin ujor të zonës. Të kihet parasysh që të tregohet kujdes gjatë furnizimit me karburant të mjeteve të punës, me qëllim që të mos ketë derdhje aksidentale të karburanteve në mjedisin e zonës. Sherbimet e mjeteve të renda të kryhen në ambiente auto-servisesh të autorizuara.

Ndikimet në tokë (Relievi, sipërfaqja, përberja e struktura të tokës, nëntoka.)

Impakti:

Nga zhvillimi i këtij aktiviteti ndikimet mbi tokë do të jenë të konsiderueshme, zhvillimi i këtij aktiviteti kërkon një hapësirë relativisht të madhe në tokë pasi kërkon një shtrirje në sipërfaqe, por nënkuptohet që nuk do të shfrytëzohet e gjitha, por vetëm një pjesë e saj për karrierën. Impakti kryesor, lidhet me largimin e shtresës (cipës) aktive të tokës pjellore, e cila shtrihet në sipërfaqen e tokës dhe përbën substratin e vetëm të gjallimit të jetës në hapsirën e fokusuar të gurorës. Ndikimi vijues lidhet gjithashtu me modifikimin e përgjithshëm të peizazhit si rrjedhojë e ndryshimit të relievit dhe e zhveshjes totale të sipërfaqes nga mbulesa bimore indigjene. Ndikimet e tjerë ekosistemike do të prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjithë habitatet e gjallesave, të cilët përfshijnë, foletë e zogjve e të shpendëve të egër, habitatet e reptilëve të njohur, të insekteve të ndryshëm etj.

Masa parandaluese:

Përshkrimi i masave operacionale që propozohen të ndërmerren për rehabilitimin e plotë e të qëndrueshëm të mjedisit në hapsirën e kavës së fraksioneve gurorë.

Pas përfundimit të procesit të prodhimit dhe pas largimit të masave me fraksione gurorë, në sipërfaqen e shfrytëzuar do të krijohet një hapsirë 'boshe'.

Subjekti që ka fituar të drejtën e shfrytëzimit duhet të kryej një punë sistematike, d.m.th të zbatojë një skemë të përfart me atë që është paraqitur në këtë dokument. Kjo do të thotë që punimet e germimeve duhet t'u nënshtrohen rregullave të rreptë tekniko-inxhinierike që bëjnë të

mundur sigurimin e një sipërfaqeje të rrafshët, aspak të deformuar dhe në të njëjtën kohë një shpat kodrinor uniform, me një pjerrësi të caktuar për të mundësuar, në vijimësi kryerjen e formatimit të tarracave që do të pyllëzohen me llojin e propozuar në këtë projekt. Sikurse theksuam, ndërhyrjet e propozuara kanë të bëjnë me pyllëzimin e të gjithë sipërfaqes së rezultuar pas shfrytëzimit të kavës së inerteve gurorë në shpatin kodrinor.

- Kriteret e pyllëzimit lidhen me tre aspekte kryesorë të cilët janë:
 - a) Formatimi i gropave në të cilat do mbillen llojet pyjorë do të jetë në përmasat 80x80x80 cm;
 - b) Mbushja e gropave do të bëhet paraprakisht me dhë pjellor të sjellë enkas për këtë qëllim;
 - c) Për pyllëzimin e sipërfaqeve do të përdoret lloji i njohur pyjorë: Peme dhe bime te tjera autoktone te zones. Te cilat i pershtaten llojit te tokes dhe klimes se kesaj zone. Keto bime jane parashikuar të mbillen në tarracat e shpatit shkëmbor. Formatimi i tarracave për pyllëzim rekomandohet të kryhet njëkohësisht dhe paralelisht me kryerjen e procesit të shfrytëzimit të kavës, kjo për arsye se më vonë, pas përfundimit të shfrytëzimit të hapësirës së kavës, procesi në fjalë paraqet vështirësi të mëdha për t'u realizuar.

Ndikimet që shkaktojnë ndryshimet klimatike (Ndryshimi i klimes, emetimi i substancave ozon-holluese.)

Impakti:

Projekti në vlerësim nuk do të përfshijë substanca të tilla që mund të ndikojnë në rritjen e përqendrimit të lendeve ozon-holluese në atmosferë. Vlerësohet vetëm lenda djegëse e mjeteve të renda të punimeve të germimit, megjithatë në nivele të ulëta. Faktor tjetër negativ mund të vlerësohet reduktimi i bimesise së zones dhe ulja e procesit të filtrimit e rigjenerimit të oksigjenit nga procesi i fotosintezës.

Masa parandaluese:

Rekomandojmë rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar dhe mbjelljen e pemëve në raport 1:3.

Ndikimet negative në habitate dhe biodiversitetin e zones së projektit

Ndikimet në biodiversitet (Flora dhe fauna)

Impakti:

Ndikimi kryesor dhe më i rëndësishëm në mjedisin biologjik është gjatë fazës së punimeve për hapjen dhe shfrytëzimin e karrierës. Nga zbatimi i këtij projekti, pritet një efekt domethënës në dëmtimin e bimesise së zones, ndonëse nuk ndodhet në zone me bimesi të lartë, por kryesisht atë shkurre e barishtore. Dëmtimi i sipërfaqes së tokës dhe i shtresës bimore, të cilat shërbejnë si habitat për një sërë gjallesash do të ndikonte edhe në largimin e faunës së zones. Kryesisht kafshet e egra, zogjtë dhe insektet e zvarraniket.

Ndikimi i zhurmave do të ndikojë edhe në largimin e faunës në një rreze disa kilometra, kjo kryesisht nga aktiviteti i përdorimit të mjeteve të renda të punës dhe transportit.

Masa parandaluese:

Rehabilitimi sa më parë i skarpatave dhe sipërfaqeve pyjore të dëmtuara dhe investimi në ndërtimin e pritave për reduktimin e erozionit. Zbatimi i projektit të rehabilitimit sipas preventivit të detajuar të punimeve rehabilituese dhe monitorimi i ecurisë së këtij procesi në vazhdimësi. Mirembajtje dhe monitorim të vazhdueshëm të terrenit problematik edhe nga erozioni natyror në segmente të caktuara.

Mbjellja e bimesise autoktone dhe sipas skemës së projektuar për të ndikuar ndjeshëm në uljen e erozionit dhe në ruajtjen e identitetit të bimesise së zones. Si rrjedhojë edhe rikthimin e faunës autoktone të larguar perkohësisht.

Shkarkimet ne mjedis dhe prodhimi i mbetjeve

Proçeset e punes ndikojne drejtperdrejte ne toke, pasi largohet shtresa aktive e tokes, largohet bimesia, prishet struktura e tokes, krijohen efekte te renda ne peizazh dhe ne relief. Ndikimi ne toke shoqerohet edhe me prodhim te mbetjeve te ngurta (sterilet), te cilet do te jene gure te pa nevojshe, dheu i germuar, i cili duhet te ruhet i veçuar per t'u perdorur me pas per punime rehabilitimi, si dhe produkt te demtuar nga avari gjate punes, por te rralla. Keto mbetje, sipas katalogut shqiptar te klasifikimit te mbetjeve emertohen me kodin: 01 01 02 (Mbetje që dalin nga nxjerrja e mineraleve jometalore), si dhe 01 04 13 (Mbetje që vijnë nga prerja dhe sharrimi i gurëve)

Keto mbetje kerkojne nje menaxhim te integruar, duke u rivendosur ne vendet e punimeve te karrieres dhe duke sherbyer si mbushes perveç tokes dhe plehut organik te importuar per kryerjen me sukses te punimeve te rehabilitimit. Sipas llogaritjeve, sasia e prodhimit te ketyre mbetjeve sterile eshte 2100 m³.

4. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.

Ndikimet ne ajer (Cilesia e ajrit, zhurmat, vibrimet, peizazhi.)

Gjate aktivitetit ne karriere do te ngrihen pluhura dhe ne rast se nuk aplikohet lagia me uje gjate sezonit me thatesire, mund te krijohet nje imazh i pakendshem. Shkarkimet e gazeve te mjeteve motorike do te jene burime te shkarkimeve te gazeve te demshme per ajrin, por jo ne nivele te larta shqetesuese. Zhurmat jane normale per nje aktivitet te tille, por qe nuk do te jene shqetesuese per zonat e banuara, pasi ato ndodhen ne largesi. Kryesisht zhurmat shkaktohen nga germimet e masivit te shkembit, nga sharrat, nga çekiçet pneumtaike, nga transporti, germimet e tokes shkembore, nga prerjet e pemeve ne rast se do te jete e nevojshe, etj. Gjate punimeve do te kete demtim te rendesishem te peizazhit te zones, nga germimet dhe humbja e bimesise, ndryshimi i relievit, heqja e shtreses aktive te tokes dhe humusit. Sheshi i parkimit dhe makinerite gjithashtu do te kene efekt ne peizazhin e zones. Demtimi i bimesise, ndikon ne uljen e cilesise se ajrit.

Ndikimet ne ujera (Ujerat siperfaqesore, ujerat nentokesore.)

Ky aktivitet nuk shoqerohet me shkarkime ne uje, pasi nuk perdor uje ne procesin e punes, nuk prodhon uje, nuk prek burimet ujore te zones.

Shkarkimet ne mjedis dhe prodhimi i mbetjeve

Proçeset e punes ndikojne drejtperdrejte ne toke, pasi largohet shtresa aktive e tokes, largohet bimesia, prishet struktura e tokes, krijohen efekte te renda ne peizazh dhe ne relief. Ndikimi ne toke shoqerohet edhe me prodhim te mbetjeve te ngurta (sterilet), te cilet do te jene gure te pa nevojshe, dheu i germuar, i cili duhet te ruhet i veçuar per t'u perdorur me pas per punime rehabilitimi, si dhe produkt te demtuar nga avari gjate punes, por te rralla. Keto mbetje, sipas katalogut shqiptar te klasifikimit te mbetjeve emertohen me kodin: 01 01 02 (Mbetje që dalin nga nxjerrja e mineraleve jometalore), si dhe 01 04 13 (Mbetje që vijnë nga prerja dhe sharrimi i gurëve)

Keto mbetje kerkojne nje menaxhim te integruar, duke u rivendosur ne vendet e punimeve te karrieres dhe duke sherbyer si mbushes perveç tokes dhe plehut organik te importuar per kryerjen me sukses te punimeve te rehabilitimit. Sipas llogaritjeve, sasia e prodhimit te ketyre mbetjeve sterile eshte 2100 m³.

5. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.

Kohëzgjatja e punimeve do të jetë disa vite, ku periudha e vlefshmerisë sipas lejes minerare të shfrytëzimit është 25 vjet, me mundësi të zgjatjes vetëm një herë të afatit për 10 vjet. Ky aktivitet, pasi të kryejë punimet për një sipërfaqe të caktuar dhe për nxjerrjen e gjithë vëllimit të gurit gëlqeror, mund të fillojë mbylljen dhe rehabilitimin e karreres, kjo në varesi të ecurisë së punimeve nxjerrëse, të klimës dhe sezonit, etj. Rehabilitimi duhet të kryhet nga vetë subjekti i zhvillimit të punimeve, ose në rast të kundërt, organet shtetërore përgjegjëse nëpërmjet garancisë financiare të rehabilitimit, kryejnë rehabilitimin e zonës ose pyllëzimin në zonë të tjera problematike.

Nuk do të ketë ndertime të përhershme, vetëm të perkohshme. Këto ndertime konsistojnë në ndertimin e një vendroje, të një objekti zyre të vogël dhe rulo për nevojat higjieno-sanitare. Rikuperimi i natyrës kërkon kohë të gjatë në mënyrë që të rikthehet afërsisht si në gjendjen e mëparshme, kjo mund të kërkojë 10-20 vjet.

6. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS

Ndikimet negative në mjedis të shkaktuara nga zhvillimi i këtij aktiviteti, shtrijnë efektet e tyre në një sipërfaqe sa të ngushtë në aspektin biologjik, aq edhe të gjere në aspektin peizazhistik, kjo në varesi të sipërfaqes së shfrytëzimit që do të preket çdo vit dhe kapacitetit të prodhimit. Ndikimet në mjedisin biologjik, mund të shtrijnë efektet deri në distancë 1-2 km, pasi prodhimi i zhurmave, përdorimi i mjeteve të renda të punës, ndikon në largimin e trembjen e gjallesave të ndryshme, si shpendet, zvarraniket dhe gjitarët e eger. Përsa i përket bimesisë, impakti është dhe më i vogël. Kjo kryesisht për sipërfaqet pyjore, pasi ndikimi në ujëra përhapet në një rreze edhe më të gjere, por në këto rast nuk ka ndikim në ujëra. Efekti në disa dhjetra kilometra është pikerisht ndikimi në peizazh. Ky efekt shkakton shqetësime e dëm mjedisore e të turizmit deri në disa km (10-15 km), kjo në varesi të relievit dhe të pozicionit të karreres që do të hapet.

Ndikimet do të zgjasin për një periudhë relativisht të shkurtër por për aq kohë sa do të ketë aktivitet në terren. Kjo do të thotë se gjatë gjithë kësaj kohe, do të ketë aktivitet me ndikime në mjedis dhe ky ndikim është afatgjatë, pasi rehabilitimi i mjedisit kërkon kohë të gjatë. Kjo është e lidhur ngushtë me ecurinë e punimeve rehabilituese, të cilat duhet të zhvillohen paralelisht me punimet ndër vite. Fillimisht rruget auto duhet të rehabilitohen menjëherë, si dhe perimetri i karreres. Pas përfundimit të aktivitetit, subjekti duhet të kryejë të gjithë rehabilitimin e sipërfaqeve të demtuara, duke i shndërruar ato në mjedise dhe peizazhe në përputhje me natyrën. Ndikimi i prerjes dhe demtimit të pyjeve do të jetë i ulët, por afatgjatë, kjo do të shtrijë efektet në disa vjet pasi demtimi i pyjeve, kërkon kohën e duhur për rehabilitimin dhe zëvendësimin e kësaj lloji bimesie dhe aktivitetin e saj në rolin që luan në natyrë dhe biodiversitet. Sipërfaqja e fokusuar për shfrytëzim, nuk karakterizohet nga peme të larta, por kryesisht bimesi barishtore. Për këto punime, subjekti duhet të zbatojë me rigorozitet punimet e përcaktuara në projektin e rehabilitimit të sipërfaqeve të demtuara. Pyllëzimi i sipërfaqeve të demtuara frenon efektin e erozionit, të largimit të faunës, të ndotjes së ujërave të procesit të filtrimit e pastrimit të ajrit (nëpërmjet fotosintezës.), redukton impaktin vizual dhe impaktin social. Këto ndikime, efektin më të madh e kanë për shkak të pozicionit dhe statusit të zonës.

7. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.

Ndikimet negativë që do të shfaqen gjatë dhe pas shfrytëzimit të kavave në sipërfaqen e marrë në përdorim, kanë të bëjnë me shkatërrimin e ekosistemit pyjor. Ato do i ndajmë në katëgoritë e mëposhtme:

- zhveshje e sipërfaqes nga llojet bimore autoktonë;
- zhdukje e gjallesave të tjera ekzistuese, zvarranikë, insekte, krimba toke etj.;
- prishje e habitateve bimore dhe e habitateve të gjallesave të tjera;
- shfaqje e fenomenit të shplarjes së tokës;
- cenim i biodiversitetit e i peizazhit natyror.

Përshkrimi i operacioneve që synojnë rehabilitimi e qendrueshem të sipërfaqeve, mbi të cilat do të nderhyet:

a) Riveshje me bimësi autoktone e sipërfaqeve të zhveshura është një ndërhyrje operacionale mjaft e njohur në vendet perëndimorë, të cilët është zbatuar në raste të tillë; ndërhyrja në fjalë konsiston në grumbullimin e farërave nga llojet e drurëve e të shkurreve që gjenden rrotull hapsirës së kavës së gurores dhe mbjelljen e tyre në tokë sipas një teknike të thjeshtë e të njohur prej bujqëve, pylltarëve e pasionantëve të pyjeve e të bimëve në përgjithësi. Kjo ndërhyrje do të

kryhet kryesisht në skarpatat e formuara nga dherave e depozituar në anën e poshtme të gurores së shpat-malit. Nuk rekomandohet ndonjë skemë mbjelljeje paraprake pasi prania e mbetjeve shkëmbore që gjenden të shpërndarë atje e përjashton atë. Një hap tjetër që rekomandohet të ndërmerret për instalimin e llojeve pyjorë në hapsirën e brendshme të kavës së gurores është gjithashtu pyllëzimi i saj me lloje shkurresh autoktone gjethe-mbajtëse, pra, që janë me gjelbërim të përhershëm, siç janë: Dëllenja e Kuqe (*Juniperus oxycedrus*), Bërsheni (*Juniperus foetidissima*). Në këtë rast, lipset ndërmarrë hapi paraprak i formimit të shtresës së dheut që nevojitet për të realizuar instalimin e llojeve që theksuam.

b) Masa praktike kundër shplarjes e gërryerjes së dherave toksore nëpërmjet aplikimit të gardheve tekë, anti-erozivë është masë operacionale, e cila rekomandohet në rastet kur, për shkak të depozitimit të inerteve tokësore në anën e poshtme të një objekti që ndodhet në shpatin e një mali, krijohen skarpata dherash, të cilët kërcënohen vazhdimisht nga shplarjet prej rreshjeve atmosferike të shirave, prej rrëshqitjeve masive dhe gërryerjeve lineare. Në këto kushte rekomandohet ndërtimi i gardheve lineare, vegjetativë për të frenuar fenomenin negativ dhe stabilizuar mjedisin toksor të skarpatës e cila do të ri-pyllumëzohet në një të ardhme të afërt.

c) Mbjellje e llojeve barishtarë të njohur, me veti të shquara për stabilizimin e shtresës toksore dhe frenimin e fenomenit të shplarjes sipërfaqësore të saj është një tjetër masë operacionale që lipset ndërmarrë për të frenuar shplarjen masive, sipërfaqësore të tokës nga rreshjet atmosferike. Farat e llojeve barishtarë, autoktonë rekomandohen të shpërndahen gjatë stinës së vjeshtës në të gjithë sipërfaqen e hapsirës së gurores, kryesisht atje ku dherat e tokës kërcënohen nga shplarjet e ujërave të shirave. Llojet që rekomandohen në këtë rast janë: Rudithi i Pyjeve (*Brachypodium silvaticum*), Telishi (*Dactylus glomerata*).

Monitorimi

Monitorimi i fillimit, vazhdimin e deri në përfundim të punimeve do të bëhet periodikisht. Për të pasqyruar realizimin e masave rehabilituese të rekomanduara, rekomandohet që monitorimi i rehabilitimit mjedisor i për çdo gurore e kavë brenda saj duhet të kryhet rregullisht gjatë tre viteve që pasojnë përfundimin e operacioneve rehabilitues.

Monitorimi, rekomandohet të kryhet nga shoqata vendore e përdoruesve të pyjeve e kullotave komunale (ShPPKK) që vepron në zonën e Nj.A. Krrabë në bashkërendim me zyrën bashkiake të menaxhimit të burimeve natyrorë (pyje/kullota) në bashkinë e Tiranë.


Monitorimi do të përfshijë dy aspekte kryesore të procesit të cilët janë:

- Fillimi dhe përfundimi i ndërhyrjeve operacionale rehabilituese nëpërmjet risjelljes së dheut pjellor, krijimit të shtresës me trashësi uniforme, 30 cm, në tarracat shkëmbore të kavave;
- Pyllëzimi i sipërfaqeve të tarracave duke zbatuar teknikat e rekomanduara për mbjelljen e llojeve pyjorë (shkurre e gjysëm-shkurre) brënda fazave stinore të theksuara në këtë dokument;
- Hartimet e situacioneve të punimeve të kryer si dhe faturat financiare të likujduara në kohë, sipas aktmarrëveshjes së nënshkruar ndërmjet palëve.

Rezultatet e përfituar periodikisht do i raportohen subjektit juridik sipërmarrës, zyrave përkatëse të menaxhimit të burimeve natyrorë në bashkitë e Tiranës si dhe zyrës rajonale të pyjeve të qarkut Tiranë.

8. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.

Rolin dhe përgjegjesinë kryesore të rehabilitimit të mjedisit e ka subjekti investitor “ANCHOR INVESTMENTS” Sh.p.k. Institucionet përgjegjëse për mbikqyrjen e punimeve rehabilituese, ecurinë e punimeve rehabilituese, mbikqyrjen e efekteve të erozionit, për raportimin e të dhënave të monitorimit të mjedisit nga subjekti, etj, janë: Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria Rajonale e Mjedisit Tiranë, Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, Drejtoria Rajonale e Sherbimit Pyjor Rrethit Tiranë, Njesia e Qeverisjes Vendore (Bashkia Tiranë), Ministria e Infrastrukturs dhe Energjisë, si dhe vetë subjekti investitor “ANCHOR INVESTMENTS” Sh.p.k nepermjet ekspertit ose subjektit nenkontraktor te perzgjedhur per kete qellim.



Monitorimi i elementeve mjedisore.

Monitorimi i cilësisë së mjedisit dhe i nivelit të elementëve ndotës të tij, shkarkimet në ajër, në ujë, në tokë dhe dëmtimi i mjedisit biologjik, kryhet sipas disa kriterëve shkencore, përta i përket vrojtimit, mbledhjes dhe analizimit të mostrave të ujit dhe të tokës, ndërsa përta i përket ndotjes së ajrit ai monitorohet direkt në terren. Procesi i monitorimit synon mbledhjen e të dhënave të nevojshme për të vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror në ndryshimet e mjedisit, ku ai është aktiv.

Objektivat kryesore të monitorimit janë:

- Për të zbuluar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit të burimeve.
- Për të siguruar informacione midis lidhjes së kushteve të burimeve të ndotjes dhe shkaqeve të tyre.
- Për të evidentuar cilësinë e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor ose ekonomik, me synim për të marrë masat e nevojshme për reduktimin e shkarkimeve dhe përmirësimin e cilësisë së elementeve të mjedisit.
- Për të vlerësuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore të hartuara dhe të ndërmarra.

Procesi i monitorimit në rang individual, sipas ligjit për mbrojtjen e mjedisit, është detyrë e shoqërisë investitore ose e nënkontraktorit për elementet, në të cilat ai ndikon. Sipas VKM Nr.1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit" pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 mund të monitorohen nga vetë investitori. Monitorimi të kryhet për shkarkimet në ajër, zhurmat, cilësinë e burimeve ujore, si dhe për punimet e rehabilitimit.

Procesi i Monitorimit

Kërkesa ligjore për kryerjen e monitorimit:

- Ligji nr. 10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", kreu VI "Monitorim i gjendjes së mjedisit";
- Ligji Nr. 10440, date 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", i ndryshuar, Kreu V, Neni 20, Pika 4).
- VKM Nr.1189, datë 18.11.2009 "Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë".

Baza ligjore për monitorim

Ligji Nr.10266 datë 15.4.2010	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
Ligji Nr. 9774 datë 12.07.2007	Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në Mjedis
VKM Nr.1189 datë 18.11.2009	Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit
VKM nr.103 datë 31.03.2002	"Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë"
VKM Nr. 435, datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve ne ajër në Republikën e Shqipërisë
VKM Nr. 803 datë 04.12.2003	Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit
Udhëzimi Nr.8 datë 27.11.2007	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara
Udhëzimi Nr. 6527 datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkarkuar nga mjetet rugore, dhe mënyra e kontrollit të tyre. i ndryshuar me: Udhëzimin Nr. 12 datë 15.06.2010
VKM Nr. 123, datë 17.2.2011	Per menaxhimin e zhurmave
VKM Nr. 313, dt. 09.05.2012	Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis

Monitorimi është detyrë e shoqërisë investitore në nivel individual për pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 të Vendimit Nr.1189. datë 18.11.2009 "Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë".

Përshkrimi i operacioneve që synojnë rehabilitimi e qendrueshem të siperfaqeve, mbi të cilat do të nderhyet:

a) Riveshje me bimësi autoktone e sipërfaqeve të zhveshura është një ndërhyrje operacionale mjaft e njohur në vendet perëndimorë, të të cilët është zbatuar në raste të tillë; ndërhyrja në fjalë konsiston në grumbullimin e farërave nga llojet e drurëve e të shkurreve që gjenden rrotull hapsirës së kavës së gurores dhe mbjelljen e tyre në tokë sipas një teknike të thjeshtë e të njohur prej bujqëve, pylltarëve e pasionantëve të pyjeve e të bimëve në përgjithësi. Kjo ndërhyrje do të kryhet kryesisht në skarpatat e formuara nga dherave e depozituar në anën e poshtme të gurores se shpat-malit. Nuk rekomandohet ndonjë skemë mbjelljeje paraprake pasi prania e mbetjeve shkëmbore që gjenden të shpërndarë atje e përjashton atë. Një hap tjetër që rekomandohet të ndërmerret për instalimin e llojeve pyjorë në hapsirën e brendshme të kavës së gurores është gjithashtu pyllëzimi i saj me lloje shkurresh autoktone gjethe-mbajtëse, pra, që janë me gjelbërim të përhershëm, siç janë: Dëllenja e Kuqe (*Juniperus oxycedrus*), Bërsheni (*Juniperus foetidissima*). Në këtë rast, lipset ndërmarrë hapi paraprak i formimit të shtresës së dheut që nevojitet për të realizuar instalimin e llojeve që theksuam.

b) Masa praktike kundër shplarjes e gërryerjes së dherave toksorë nëpërmjet aplikimit të gardheve tekë, anti-erozivë është masë operacionale, e cila rekomandohet në rastet kur, për shkak të depozitimit të inerteve tokësore në anën e poshtme të një objekti që ndodhet në shpatin e një mali, krijohen skarpata dherash, të cilët kërcënohen vazhdimisht nga shplarjet prej rreshjeve atmosferike të shirave, prej rrëshqitjeve masive dhe gërryerjeve lineare. Në këto kushte rekomandohet ndërtimi i gardheve lineare, vegjetativë për të frenuar fenomenin negativ dhe stabilizuar mjedisin toksor të skarpatës e cila do të ri-pyllëzohet në një të ardhme të afërt.

c) Mbjellje e llojeve barishtorë të njohur, me veti të shquara për stabilizimin e shtresës toksore dhe frenimin e fenomenit të shplarjes sipërfaqësore të saj është një tjetër masë operacionale që lipset ndërmarrë për të frenuar shplarjen masive, sipërfaqësore të tokës nga rreshjet atmosferike. Farat e llojeve barishtorë, autoktonë rekomandohen të shpërndahen gjatë stinës së vjeshtës në të gjithë sipërfaqen e haspirës së guroreve, kryesisht atje ku dherat e tokës kërcënohen nga shplarjet e ujërave të shirave. Llojet që rekomandohen në këtë rast janë: Rudithi i Pyjeve (*Brachypodium silvaticum*), Telishi (*Dactylus*).

Ne menyre të përgjithshme paraqesim disa masa të tjera që duhet të zbatohen nga investitori ose nenkontratesit për zhvillimin e aktivitetit. Ndikimet negative në mjedis gjatë zbatimit të projektit janë në nivele të konsiderueshme, ato konsistojnë në demtim të siperfaqeve pyjore dhe të peizazhit të zones. Kështu që gjykojmë se janë tepër të nevojshme që në vija të përgjithshme të kihen parasysh dhe të ndermerren disa masa nga kompania:


- Lagia e shesheve dhe kantierit gjatë punimeve dhe larja e automjeteve para daljes nga kantieri për të minimizuar ngritjen e grimcave të ngurta (pluhurave) në ajër.
- Të sistemohet dhe rehabilitohen të gjitha skarpatat dhe të kryhen punime mbrojtëse nga erozioni dhe efekti gërryerës.
- Të respektohen 100% masat e percaktuara në projektin e rehabilitimit të siperfaqeve mjedisore të demtuara.
- Automjetet e transportit të qarkullojnë me shpejtesi të ulët në zonat e banuara dhe në rruget e pa asfaltuara.
- Gjatë transportit të perdoren mushamate e kamionave për të shmangur përhapjen e pluhurit e të inerteve në rruget e qendrave të banuara dhe të rrugëve nacionale.

- Subjekti ka përgjegjësinë e plote të rehabilitojë të gjitha sipërfaqet e demtuara dhe ta rikthejë vendin në gjendjen e mëparshme të ngjashme me pamjen natyrale.
- Subjekti duhet të raportojë në mënyrë periodike çdo 6 muaj pranë AKM për zbatimin e kushteve të Deklaratës Mjedisore, si edhe lejes mjedisore pas pajisjes me një të tillë, e cila është e detyrueshme para fillimit të punës.
- Para prerjes së pemeve pyjore, të largohen nepërmjet zhurmave të gjitha gjallesat e botes shtazore të këtij habitati.
- Të zbatohen me rigorozitet kushtet teknike të punës në kantiere.
- Të mos ndizen zjarre nga punëtoret në zonën e karrrieres apo të shpatit malor.
- Të mos përdoren lëndet plasuese në asnjë rast. Të punohet vetëm me çekiçe pneumatike dhe me sharra me kavo prerese të masivisht shkëmbor.
- Të mos krijohen shqetësime në qarkullim dhe tek banoret e zonës në asnjë rast.
- Duhet të punohet sipas rregullores së kushteve teknike, nuk duhet të lejohen derdhje të karburanteve dhe lendeve të tjera djegëse në mjedisin e aktivitetit, pasi ndotin ambientin dhe mund të jenë burim aksidenti të shkakuar nga zjarret të pa dëshiruara.
- Në sheshin e aktivitetit, nuk duhet të magazinohen materiale të rrezikshme.
- Mjetet rrugore që qarkullojnë duhet të jenë konform normave të përcaktuara dhe të testuara nga Qendra e Kontrollit Teknik të automjeteve dhe të pajisura me certifikatën përkatëse.
- Punëtorët që do të ndodhen në mjedisë ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin duhet të përdorin masa mbrojtëse për shqisat e degjimit (Kufje ose tapa për veshet).
- Të rehabilitohet sipërfaqja përreth objektit, duke u gjelberuar dhe duke krijuar një efekt ndihmës në reduktimin e zhurmës, peizazhit dhe të pluhurit.
- Të menaxhohen mbetjet e ngurta duke u rivendosur gjatë punimeve rehabilituese në karrrierën nga ku janë prodhuar.
- Të ruhet peizazhi i zonës gjatë punimeve, të maskohen me bimesi gjithë skarpatat e rrugëve ndihmëse, si dhe sheshet e karrrierave që do të çelen.


9. NDIKIMET NË MJEDISIN NDËRKUFITAR TË PROJEKTIT

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton dëmim të mjedisit nderkufitar. Projekti nuk ndikon në cenimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit të shteteve fqinje, as të qendrave të banuara të rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet cilësia e ajrit në kontekstin nderkufitar. Për këtë kapitull, nuk kryhen vlerësime dhe analiza të detajuara për shkak të vendodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distancës që ai ruan me kufirin dhe shtet fqinje.

Aneks: Harta Topografike e sipërfaqes për shfrytëzim



INFORMACION PËR NDËRVEPRIMIN NË MJEDIS
SHFRYTËZIMI I MINERALIT GUR GËLQEROR, OBJEKTI "SKUTERRE", ZONA MINERARE NR.318/1
(ISH LEJA MINERARE NR, 1206), SKUTERË, KRRABË, TIRANË



Nomeklatura e Hartës në shkallë 1:10000 (K-34-100-B-d-2)



Tabela: Koordinatat e Porjektit

Koordinatat e sipërfaqes se shfrytëzimit sipas Njoftim Fituesit					
Koordinatat ne sistemin Gaus Kruger			Koordinatat ne sistemin KRGJSH		
Nr.	E (Y)	N (X)	Nr.	E (Y)	N (X)
1	4415010	4566283	1	498727.17	4565655.12
2	4414750	4566450	2	498465.03	4565819
3	4414920	4566720	3	498632.14	4566090.82
4	4415200	4566540	4	498914.03	4565914.15
Koordinatat e sipërfaqes te ZONES A qe do te shfrytëzohet					
1	4414867.596	4566374.467	1	498583.46	4565744.91
2	4415010	4566283	2	498727.17	4565655.12
3	4415200	4566540	3	498914.03	4565914.15
4	4415102.347	4566602.777	4	498815.72	4565975.63
5	4415036.936	4566535.07	5	498751	4565907.23
6	4415032.182	4566530.312	6	498746.38	4565902.47
7	4414998.372	4566497.593	7	498712.92	4565869.43
8	4414988.043	4566482.1	8	498702.84	4565854.03
9	4414972.696	4566461.967	9	498687.72	4565833.73
10	4414952.983	4566442.217	10	498668.26	4565813.43
11	4414930.713	4566425.403	11	498646.14	4565796.35
12	4414923.111	4566420.825	12	498638.58	4565791.87
13	4414922.867	4566420.533	13	498638.16	4565791.45
14	4414911.512	4566408.022	14	498627.1	4565778.71
15	4414890.565	4566389.585	15	498606.23	4565760.13
16	4414867.596	4566374.467	16	498583.46	4565744.91



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 5129 Prot.

Tiranë, më 22.06 2017

Nr. identifikues 426

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Z. ADHURIM ÇAUSHI

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRIA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E MJEDISIT

Lefter KOKA



E vlefshme për subjektin "Anchor Investment" IPK.
për informacion e kërkuar në ngjarje.
Projekti: shfrytëzimi i miratimit gur gëlqeror.
vendodhja: Q. Tiranë B. Tiranë. Nj. Ad. Krrabe.
skutërië. objekti "skutërië" zn. miratimi
Nr 381/1 (i th. leje minecarë Nr. 1206)

ADHURIM ÇAUSHI





Numri serial: LN-3639-08-2017
NUIS/NIPT: L62412026R

LICENCË

Subjekti: Adhurim Çaushti

Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE, Njesia Bashkiake nr 7, Rruga Ndre Mjeda, Rezidenca Eagle, Nr 3006

Kodi: III.2.A (1+2) Kod tjetër:

Data e lëshimit: 01/08/2017 Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Emërtimi përshkruar i veprimtarisë

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor dhe ndikim në mjedis)

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Veprimtari specifike

- Ndikim në mjedis
- Auditim mjedisor

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Specialiteti

E vlefshme për subjektin "Anchor Investments" spk për informimin i ndërmjetësues në mjedis. Për kërkim gjurmues mimeralë qur qëllon vendetja: q Tirane, Bilkanë, VjAd, Korabë, Skutertë objektet "skutertë" za minerale 2011

Ky dokument mbetet pronë e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe duhet të ruhet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji ose ndërpritet detyrimi i ligjor për të qenë person i titulluar.

Nënshkrimi i sportelit:

ADHURIM ÇAUSHI



ADHURIM ÇAUSHI

H&M MINING
Projekte dhe Konsulence
NIPT: L 62412026 R
TIRANË - ALBANIA